

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7623 E premte 17 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje

në "Zëri i Amerikës"

Nga DAVID KANIN



Çështja kryesore është sovraniteti i Kosovës, jo shkëmbimi i territoreve

Një ekspert i çështjeve të Ballkanit, ish-analist i lartë i CIA-s për rajonin dhe Evropën, thotë se patologjia e Perëndimit për çdo zhvendosje territori...
Vijon në faqen 20-21

Opinion

Ditës

Nga SULEJMAN MATO



Kini kujdes me sherret e çfarëdo lloji, nga më seriozet, gjer te sherret banale! Vrasësit i kemi rrotull. Kriminelët i kemi midis nesh. Jetojnë midis nesh. Flasin ...
Vijon në faqen 21

Kujdes me sherret... vrasësit i kemi rrotull!



Debat/ Letërsia e kohës së diktaturës

PD: Të "vulosen" veprat me ideologji. Toçi: Kush i siglon veprat e Kadaresë?

Agron Tufa: Veprat "të identifikohen". Fatmir Toçi kundër: Listë censure mbi censurën

FATMIRA NIKOLLI

Prej disa muajsh Partia Demokratike ka nisur punën për hartimin e një kuadri ligjor që i shërben sipas saj, dekomunistizimit të shoqërisë shqiptare. Drafti i hartuar i është çuar për mendim nga pikëpamja historike ...
Në faqen 10-11

DOKUMENTET/ NUK NEVOJITET GARANCIA FINANCIARE PER TE APLIKUAR

AMBASADA E SHBA: KUSHTET E REJA PER VIZE TURISTIKE

Procedura për t'u pajisur me vizë për një vizitë përtej Atlantikut. Ambasada: Mos sillni letra nga banka në intervistë, vendimet i merr oficeri konsullor



(Në foto) Ambasada amerikane në Tiranë

MESAZHI

"Magjistratura", deputeti gjerman: Shumica të nisë bisedimet me PD

Në faqen 3

INTERVISTA

Ish-e përndjekura Ajtanga Lubonja: Jeta mes vuajtjesh, politika më harroi

Suplement

SA DO TE PAGUANI

Rriten deri në 35% çmimet e teksteve të arsimit

parauniversitar


Në faqen 8

DESHMIA NE GJYQ

U arrestua me 19 pistoletë në kufi, suedezi: Po bëja vetëm transportin

Në faqen 6

LISTA EMERORE



ALUIZNI: 900 familjet që kanë gati lejet e legalizimeve

Në faqen 18-19

I riu po peshkonte në lumin Seman kur pa nënën që tentoi të vriste vajzat

Rrëfimi: Si i shpëtova 2 fëmijët nga mbytja

Admir Murataj: Gruaja tentoi t'u fuste thonjtë në fyt në sy të policisë

FIER- Një i ri i papunë, i cili po peshkonte në ujërat e lumit Seman ka shpëtuar vajzat binjake të 42-vjeçares Rudina Kishta, e cila në gjendje të rënduar psikike tentoi të mbyste 6-vjeçarët. Pak ditë pas ngjarjes së rëndë, Admir Murataj tregoi me detaje



se si i shpëttoi dy të miturat. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Murataj u shpreh se 42-vjeçarja tentoi të mbytej së bashku me të bijat. "U hodha direkt në lumë dhe notova në drejtim të tyre. Njërin nga vajzat e kam nxjerrë ...

Në faqen 7

KORRUPSIONI VETINGU

Ish-kryeministri nxjerr dokumentet për anëtarin e KPK-së: U ndoq penalisht për korrupsion

Berisha: Komisionerja e vetingut, kontakte me trafikantë e kriminelë

"Me nënën pensioniste bleu apartament 180.000 euro"

Valentina Madani

Ish-kryeministri Sali Berisha, duke iu referuar mesazhit të qytetarit dixhital, publikoi dje disa dokumente përmes së cilave akuzon anëtarin e KPK, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Valbona Sanxhaktari për korrupsion dhe kontakte me trafikantët. Sipas Berishës, ajo është ndjekur penalisht për afëra korruptive të denoncuar nga KLSH dhe se para parlamentit ka fshehur faktin se ka qenë e ndjekur penalisht ndonjëherë. Sipas denoncimit në adresë të ish-kryeministrit, komisionerja Sanxhaktari bashkë me nënën pensioniste blenë një apartament 180.000 euro, ndërkohë që ka pasur kontakte me trafikantë dhe kriminelë. Berisha përmend se ish-bashkëshorti i saj është person i rrezikshëm, pjesë e grupit të famozit Geron Xhafa, i përzënë si person i rrezikshëm për rendin nga policia italiane. Ish-bashkëshorti i saj, person i rrezikshëm, pjesë e grupit të famozit Geron Xhafa, i përzënë si person i rrezikshëm për rendin nga policia italiane.

uara nga KLSH. Ndrikull Sanxhaktari ka fshehur para parlamentit se nuk ka

qenë e ndjekur penalisht ndonjëherë. Ajo vetëm me nënën pensioniste blenë një

apartament 180.000 euro. Ajo ka pasur kontakte me trafikantë dhe kriminelë. Ish-bashkëshorti i saj, person i rrezikshëm, pjesë e grupit të famozit Geron Xhafa, i përzënë si person i rrezikshëm për rendin nga policia italiane. 'Miss korrupsioni' i grupit të Dvoran Vektorëve". Berisha shton më tej: "Udhëton sipas sistemit TMS jashtë me makinën e 'TCH' me targë TR216RP të drejtorit të 'Dixhitalb', Alban Jaho dhe siç dihet, ky televizion ka procese të mëdha gjyqësore për pronësi. Këtu më poshtë keni mesazhin dhe të gjitha dokumentet që faktojnë akuzat e qytetarit dixhital".



Ish-kryeministri Sali Berisha

DENONCIMI

"Ndrikull Sanxhaktari ka fshehur para parlamentit se nuk ka qenë e ndjekur penalisht ndonjëherë. Ajo vetëm me nënën pensioniste blenë një apartament 180.000 euro. Ajo ka pasur kontakte me trafikantë dhe kriminelë. Ish-bashkëshorti i saj, person i rrezikshëm, pjesë e grupit të famozit Geron Xhafa, i përzënë si person i rrezikshëm për rendin nga policia italiane.

Një ftesë e hapur për di nalog, mazhoranca e la të hapur për opozitën sessionin që shko, por Edi Paloka i sheh thirrjet për tryeza si lojë të Edi Ramës. "Ligji i Magjistraturës është ligj që lidhet me reformën në drejtësi. Reforma në drejtësi është thënë tashmë jo vetëm nga ne, por edhe nga vëzhguesit realistë të kësaj të ashtuquajtur reformë në drejtësi se ka dështuar. Pse? Sepse kështu ka dashur Edi Rama. Pastaj ftesat për bashkëpunime dhe të tjera janë lojëra të zakonshme të Ramës, që dihet se ku të çojnë. Për çfarë duhet tryeza, ne i kemi renditur pikat si mund të rikthehet reforma në drejtësi në binarët e saj kushtetuese. Sepse kjo është kryesorja, u shkelën ato ndryshime kushtetuese që u bënë me konsensus, me ligje antikushtetuese, që u bënë nga mazhoranca. Nëse nuk kthehemi aty, çfarë kuptimi ka. Të dalë opozita

"Rama po mbro mbron gjyqtarët dhe ministrat e korruptuar"

PS ftoi për dialog, Paloka: Shqiptarët duan rrëzimin e kryeministrit"



t'i japë si buqetë me lule drejtësinë Ramës në dorë. Që të bëjë atë që po bën, sepse i vetmi qëllim i tij të mbronte gjyqtarët e korruptuar dhe përmes tyre të mbronte ministrat dhe qeveritarët e korruptuar dhe atë që po bën", tha z.Paloka për "News 24". Opozita premtion surpriza dhe aksion të fortë si brenda dhe jashtë parlamentit. "Aksioni i

opozitës do të jetë në vazhdim. Reagim ynë në vijim do të jetë me një qëllim, largimi i qeverisë, thekson nënkryetari demokrat. Mijëra demonstrues kanë mbushur rrugët e Bukureshtit për të kërkuar dorëheqjen e qeverisë rumune të social-demokratëve, por a presim një skenar rumun edhe në Shqipëri? "Që shqiptarët duhet të ngrihen



Gjatë një seance parlamentare

Akuza



LUÇIANO BOÇI

Deputeti Luçiano Boçi deklaroi dje se pas kërkesave të PD për libra falas, qeveria i është përgjigjur me harbutëri duke rritur paketat e teksteve shkollore. "Nxënësit e vegjël penalizohen nëse i shkarravin, nëse i shënojnë, nëse i grisin, sepse ata duhet t'i dorëzojnë. Për fëmijët sipas qeverisë, kujtimet e fëmijërisë të lidhura me Abetaren, me shkrimin e parë, me vizatimet e para, me gjithçka që formëson botën e fëmijës, duhet të zhduken", tha z.Boçi.

Nishani: Shqipëria po zhbëhet, në 2030 do jemi më pak se 1 milion

Ish-presidenti Bujar Nishani komentoj dje të dhënat e INSTAT-it lidhur me popullsinë në vend. Ish-presidenti thotë se shqiptarët po largohen çdo ditë për shkak të pasigurisë, frikës, ambientit armiqësor dhe mungesës totale të funksionimit të shërbimit shtetëror. "Shqipëria po zhbëhet! Në vitin 2030 do jemi më pak se 1 milion! Po nuk e ndaluan ringjalljen e së keqes, në 2040 do katandisemi ndoshta vetëm disa qindra mijë!", theksoi z.Nishani. Sipas tij, "pasiguria e shqiptarëve vijon të shtohet. Shpresa tek të gjitha gjeneratat për të nesërmen po shuhet me shpejtësi, ika nuk ndalon! Territori do t'u jetë atyre që e lakmuan dhe synuan ndër shekuj, por veç sot po marrin nga markato-diplomacia e vullëbajtësve. Mua prisni që qeveritarëve t'ua ndjejë për këtë zhbërje".



AFERA

PD-ja akuzon qeverinë se premtimi për shëndetësi falas ishte një mashtrim. Deputetja Lindita Metalaj tha se pas 5 viteve, shqiptarët paguajnë më shtrenjtë për jetën.

në protesta nuk ka dyshim më për askënd, paralelet me Rumaninë janë pak. Jam i bindur që kërkesën për ndryshimin dhe rrëzimin e kësaj qeverie e kanë shqiptarët si brenda dhe jashtë kufijve. Do vijojmë reagimin tonë dhe qëllimi është vetëm një, rrëzimi i qeverisë", u shpreh Edi Paloka.



Vrasja e shumëfishtë e Selenicës ishte një makabritet tronditës, për të cilin u reaguua menjëherë; u ndalua autori dhe drejtësia ka nisur procesin ligjor", deklaroi dje kryeministri Edi Rama, duke iu përgjigjur një komentuesi në rrjetin social "Facebook". Komentuesi i është drejtuar Ramës me fjalët: "Për masakrën e Selenicës as gjysmë fjale, as shprehje keqardhjeje për viktimat, as dënim të dhunës apo thirrje për çarmatim... për #pray for greece# apo #...tutti fratelli e sorelle...# të parët, patjetër... jemi djem me kulturë ne, flasin edhe anglisht, edhe taljone... nuk jemi fshatar injorant". Ishte ky komenti ironik i qytetarit, pas

Kryeministri: S'ka bërë vaki që shteti të dërgojë ngushëllime për vrasjet

Vrasja e shumëfishtë në Selenicë, Rama: Shteti reagoi menjëherë



Kryeministri Edi Rama

shprehjes së ngushëllimeve për tragjedinë e Xhenovës nga kryeministri Rama. Në komentin e tij, kryeministri tha: "E kam

parë këtë koment të përsëritur nga keqdashës të njohur botërisht a komentatorë të irrituar pafajësisht. Të parëve s'kam ç'u

bëj, vesi do t'u dalë me shpirtin. Të dytëve u them dashamirësisht se janë gabim! S'ka bërë e s'bën vaki që shteti a kryeministri qoftë, të dërgojnë ngushëllime për krimin e vrasjes. Sepse familjarët e viktimave të një krimi nuk presin fjalë ngushëllimi nga shteti a nga kryeministri, po reagim, ndalim e ndëshkim të vrasësve", shkroi Rama. "Fatkeqësisht - shprehet kryeministri - krime të tilla ndodhin kudo në botë dhe s'ka shtet që i ka ndaluar dot. Po përtej të gjitha fjalëve, shteti e bëri detyrën e vet pa humbur kohë dhe kjo s'duhet harruar teksa tihen llafe që i merr era", thekson Rama.

Ngërçi i krijuar me Shkollën e Magjistraturës, Bundestagu gjerman propozim të ri për mazhorancën

Frei: Ekspertë të huaj për përzgjedhjet në gjyqësor

Deputeti gjerman: PS të fillojë bisedimet me opozitën

Gjermania ka sjellë në Tiranë një propozim të ri për qeverinë "Rama" dhe opozitën për të zgjidhur ngërçin e krijuar pas dështimit të miratimit me konsensus të projektligjit për magistratët e rinj. Në një intervistë për "Klan Plus", reporteri për Shqipërinë në Bundestag, Thorsten Frei propozon që palët të bien dakord për ekspertët ndërkombëtarë që duhet të përfshihen në procesin e përzgjedhjes së pozicioneve kyçe në gjyqësorin shqiptar. "Tema është shumë e rëndësishme për Shqipërinë dhe suksesin e reformës gjyqësore. Prandaj, unë mund ta kuptoj pse PD dhe LSI nuk e mbështesin një zgjidhje, që nga jashtë duket e pabalancuar, por është e qartë se duhet gjetur një zgjidhje. Para së gjithash, është e rëndësishme që PS të fillojë të bisedojë me opozitën, të dëgjojë argumentet e saj dhe të kërkojë një kompromis. Ky është kryesisht detyrimi i qeverisë së Edi Ramës. Një kompromis mund të jetë që palët të bien dakord që ekspertë ndërkombëtarë dhe të pavarur të përfshihen në proceset e përzgjedhjes për pozitat kyçe në gjyqësor", deklaroi deputeti gjerman. Socialistët kërkuar të miratoheshin në Kuvend ndryshimet për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve që bashkiko-



Reporter për Shqipërinë në Bundestag, Thorsten Frei

nin që deri në ngritjen e institucioneve të reja, Shkolla e Magjistraturës të pranonte 25 studentë, ndërsa emërimet e magistratëve të rinj të bëhen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe kryeprokurorja e përkohshme, Arta Marku. Kuvendi ka mbyllur seancën e fundit për këtë sesion parlamentar, me shtyrjen e votimit për mungesë të 84 votave. Për shkak të mosjetes së gjuhës së konsensusit mes opozitës dhe kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi është detyruar që të njoftojë shtyrjen e votimit të kësaj çështjeje të rëndësishme për sesionin e ri parlamentar, që nis në shtator. Vendimi erdhi pa varësisht kërkesës së kreut të grupit parlamentar të LSI-së që Kuvendi të vijojë të

punojë, duke anuluar edhe pushimet deri në kalimin e këtij ngërçi, që sipas tij dëmtor rëndë sistemin e drejtësisë në vend. Duket se gjithçka po i lihet në sjesë së sesionit parlamentar në shtator. **PROJEKTILIGJI** Krijimi i vakancave në gjykata dhe prokurori për shkak të moskalimit të procesit të vetingut nga gjyqtarë e prokurorë, si dhe vonesat në ngritjen e organeve të reja të drejtësisë, që duhet të bëjnë emërimin e magistratëve të rinj bëri të domosdoshme, sipas mazhorancës, ndërhyrjen në Ligjin për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja dhe deputetja Klodilda Ferhati depozituan që në muajin maj një draft në Kuv-

end, përmes të cilit kërkojnë që Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe prokuroria të mund të emërojnë gjyqtarët dhe prokurorët e rinj që mbarojnë shkollën e Magjistraturës, deri sa të ngrihen Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kompetencë kjo që iu ishte hequr dy institucioneve ekzistuese me ndryshimet e bëra, si pjesë e paketës së Reformës në Drejtësi. "Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe me qëllim plotësimin e nevojave për funksionimin e sistemit të drejtësisë, ngarkohet Shkolla e Magjistraturës të organizojë jo më vonë se muaji tetor, konkursin për pranimin e 25 kandidatëve për magistratë për vitin akademik 2018-2019 dhe të dyfishit të këtij numri për vitin akademik 2019-2020. Për shkak të situatës së krijuar nga mosngritja e KLP dhe KLGJ, shkolla e Magjistraturës nuk e zhvilloi konkursin për pranimit e reja në muajin prill. Në relacionin që shoqëron projektligjin, dy deputetë e mazhorancës argumentojnë se ngritja e këshillave nuk është ende e mundur dhe nuk mund të parashikohet cili do të jetë afati i krijimit të tyre, ndaj ky ndryshim në ligj shihet si e vetmja zgjidhje.

Forcat Speciale Shqiptare rikthehen në Afganistan për trajnimin e komandove afganë

Forcat Speciale shqiptare rikthehen pas 6 vitesh në Afganistan. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ka postuar në faqen e saj zyrtare në "FB", një foto nga trajnimi që forcat tona speciale po u bëjnë komandove afgane në misionin "Resolute Support Mission". "Krenari PërFA", shkroi ministria e Mbrojtjes. Prezenca e forcave speciale shqiptare në Afganistan vjen si mbështetje e strategjisë së re të presidentit Donald Trump në Afganistan. Strategjia e re e Presidentit të Shteteve të Bashkuara parashikon një qëndrim me agresiv në terren ndaj talebanëve dhe terrorizmit.

NJOFTIM ANKANDI
 Me date 17.08.2018 Permbasuesja Gjyqësore Ermira Mhilli shpall ankandin për shijën e pasurisë së paluajtshme e flojt Ndertese, Kati per dhe pa ndarje Dyqan me sip. 113 m2, me nr. radhori 1587 date 23.11.1988 e ndodhur ne Z.K.8392 L.aj. "Naim Gjylbegu" Rr. Sali Nivica/Shkoder
 Çmimi fillues për Shijën ne Arkandi është ne vlerën 4.718.890 leke (Kater milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë)
 Shija e pasurisë do te behet (zhvillohet) ne ambientet e Zyres se Permbasueses Gjyqësore Ermira Mhilli me adresë Laj. "Ozma Saliu" Rr. "Don Bosko", dhe do te perfundojë me at. 16.09.2018 ora 15:00 (ne perfundimin e orarit zyrtar)
 Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumën prej 10% te vleres si garanci ne Bankën Raifaisen-Dega Shkoder
 Oferuesat te drejtohen prane Zyres se Permbasueses Gjyqësore Ermira Mhilli, ose te kontaktojnë nepermjet Nr.tel 0692219253 ose adreses se emailit. gmirra.mhilli@hotmail.com

Zvministria e Brendshme, Romina Kuko po zhvillon një vizitë në SHBA, me ftesë të Departamentit të Shtetit. Në axhendën e kësaj vizite janë programet e shkëmbimit të eksperiencës në fushën e sundimit të ligjit si dhe ato për luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Kuko ka zhvilluar takime zyrtare në Byronë e Kundërterrorizmit, në Byronë e Çështjeve Europiane si dhe në Departamentin e Sigurisë së Brendshme (Homeland Security). Gjatë këtyre takimeve, u rikonfirmua

Zvministria e Brendshme, Romina Kuko, takime në DASH

SHBA, mbështetje Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar

mbështetja amerikane ndaj vendit tonë për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Po kështu u vlerësuan hapat e ndërmarra në fushën e hetimit të përbashkët, si një dëshmi e bashkëpunimit konkret mes agjencive ligjzbatuese të të dyja vendeve.

Nga ana tjetër, palët ranë dakord për intensifikimin e programeve të asistencës në sistemet teknologjike dhe burimet njerëzore në fushën e hetimit të përbashkët. Zvministria Kuko zhvilloi gjithashtu disa takime të frytshme në Institutin e SHBA për Paqe dhe në Qen-

drën e Hulumtimit Teknologjik, ku u diskutua rreth luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm. Zvministria Kuko prezantoi në këto biseda me zyrtarët amerikanë, masat e marra nga vendi ynë në këtë drejtim. Po ashtu u diskutua edhe për realizimin e një projekti



konkret të përbashkët. Në tryezat e zhvilluara u shkëmbyen përvojat specifike në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Ekspertët e fushës pranë këtyre organizatave paraqitën raste ilustruese nga gjithë bota, që u çmuan me interes nga palët.

Afrimi i zgjedhjeve, zv.kryetarja e Kuvendit lëshon thirrjen

Në më pak se një vit nga zgjedhjet venore në Shqipëri, duhen marrë masa nga aktorët përkatës për të adresuar sfidat që lidhen me pjesëmarrjen e grave në politikë. Organizata ndërkombëtare "Un Women" që operon edhe në Shqipëri, në drejtim të drejtave të grave, ka theksuar se pjesëmarrja e grave në politikë ka ende sfida që duhen adresuar. Një nga zërat më të fuqishëm në drejtim të adresimit të sfidave të tilla, zv.kryetarja e parlamentit, Vasilika Hysi ka theksuar se i duhet dhënë fund kandidimit formal të grave në politikë, duke refuzuar dorëheqjen e tyre për t'i lënë mandatin një burri. "I duhet dhënë fund praktikës së kandidimit formal të grave dhe vazhde dhe duhet refuzuar dorëheqja e tyre për t'i lënë mandatin një burri", - thotë zv.kryetarja e parlamentit, Vasilika Hysi. Problemet me dorëheqjet e grave si kandidatet për deputete u bënë masive në zgjedhjet parlamentare të 2013-ës. Kështu, për të hyrë në parlament Arben Noka, dy kandidatet femra të PS-së dhanë dorëheqjen: Mirela Neli dhe dorëheqjen, pasi përfitoi vendin nga dorëheqja më përpara e kandidatës Merjeme Delishi. Kjo e fundit dha si shkak problemet e saj shëndetësore, gjë që e pengonin për të qenë aktive në parlament. Për vendimet të kryeministrit Edi Rama se të gjithë ata që do të jenë ministra duhet të dorëzojnë mandatin e deputetit, ishte Mimi Kodheli, e cila për shkak të marrjes së mandatit si ministre e Mbrojtjes në shtator 2013, i la vendin kandidatit të radhës, Mejreme Delishi. E kështu, pas dorëheqjes së Delishit i erdhin radha Mirela Nelit, që gjithashtu dha dorëheqjen, pa dhënë arsye të qenësishme për t'i lënë vendin Arben Ndokës. Ndërkohë, edhe LSI atëherë në koalicion me PS ndoqi të njëjtën taktikë. Pas lënies së mandatit të Lefter Kokës në Durrës, meqenëse u bë ministër i Bujqësisë, erdhi kandidatja Silvana Maksuti, e cila dha dorëheqjen për t'i lënë vendin Bujar Dervenit. Pas këtyre taktikave reaguan edhe shoqatat e grave. Rrjeti i "Grave Barazi në Vendimarrje" në një njoftim për mediat tha se sheh me shqetësim mënyrën e zëvendësimit të mandateve të ministrave në Kuvendin e Shqipërisë.

Vasilika Hysi: Gratë kandidatet të refuzojnë dorëheqjet për t'ua lënë mandatin burrave

Në zgjedhjet e 2013-ës, vetëm në Lezhë u dorëhoqën 3 gra



"I duhet dhënë fund praktikës së kandidimit formal të grave dhe vazhde dhe duhet refuzuar dorëheqja e tyre për t'i lënë mandatin një burri"

VASILIKA HYSI ZV/KRYETARE E PARLAMENTIT

DENONCIMET
Deputetja e PD-së në vitin 2013, Mesila Doda kërkoi reagimin e Kuvendit dhe të kryeministrit Rama për lënien e mandatit nga ana e tri grave, sipas saj të detyruara. Kryetari i atëhershëm i Kuvendit, Ilir Meta i sugjeroi deputetes të bënte denoncimin dhe të mos bazohet në propagandën politike. Ish-kryeparlamentarja Jozefina Topalli tha se kandidatet e Lezhës ishin kërcënuar.

Presidenti i Republikës viziton komunën e Shterpçës

Meta: Bashkëjetesa midis serbëve e shqiptarëve është e admirueshme

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ndodhet në komunën e Shterpçës në Brezovicë të Kosovës. Meta ka vizituar fermerat ku kultivohen mjedrat. Përmes një statusi në rrjetin social "Facebook", Meta tha se Shterpça është një komunë model, pasi bashkëjetesa midis serbëve e shqiptarëve është e admirueshme dhe solide. "Kënaqësi të vizitoja fermerat ku kultivohen mjedrat më të mira në botë, në komunën e Shterpçës (Brezovicë) dhe një investim bashkëkohor të përpunimit dhe ruajtjes së frutave të pyllit. Vizioni i Bratislavit, kryetarit të komunës mbështetur



tek shpirti punëtor i këtij komuniteti të shkëlqyer ka sjellë ndryshime tepër shprehëdhënëse, duke hapur vende të reja pune dhe të ardhura më të mira për banorët dhe komunën. Shterp-

ca është një komunë model, ku bashkëjetesa midis serbëve e shqiptarëve është e admirueshme dhe solide", shkroi djepresidenti Meta, ndërsa postoi disa foto nga vizita e tij.



Braçe publikon foton e Berishës në kazino: Favoret fiskale që masivizuan bixhozin

Deputeti socialist Erion Braçe, në një postim të fundit në rrjetet sociale është ndalur tek ndryshimet në ligjin për lojërat e fatit. Në një shkrim të gjatë ku është publikuar edhe fotoja e ish-kryeministrit Sali Berisha në një kazino. Braçe thotë se gjatë kohës kur Berisha qeveriste, ka pasur një numër rekord të favoreve fiskale që kanë masivizuar bixhozin. Fotoja ku Berisha është fotografuar në kazino është e shumë viteve më parë, megjithatë duket se Braçe nuk është ndalur tek komentit mbi foton, por tek propaganda që sipas tij, Partia Demokratike po përdor për këtë debat. "23% tatim fitimi dhe 20% tatim mbi të ardhurat për lojtarët në vitin 2005. 10% tatim fitimi dhe 0% tatim mbi të ardhurat për lojtarët në vitin 2008. Favoret fiskale rekord të Sali Berishës që masivizuan bixhozin. Nga vitin 2015-ës, asnjë licencë e re. Propozimi im: Tatim progresiv mbi fitimet e kompanive nga lojërat e fatit në nivelin e sipërm deri në 50%. Tatim progresiv mbi të ardhurat e lojtarëve fitues nga lojërat e fatit në nivelin e sipërm deri në 50%. Pjesa tjetër, të zbatohet ligji për t'i larguar nga qytetet dhe zonat e banuara, për distancat e reklamat", shkroi dje deputeti socialist, Braçe.

FOTOJA
Fotoja ku Berisha është fotografuar në kazino është e shumë viteve më parë, megjithatë duket se Braçe nuk është ndalur tek komentit mbi foton, por tek propaganda që sipas tij, Partia Demokratike po përdor për këtë debat.

Kreu i DRPSHTRR: Ja si kryhet njohja dhe konvertimi i lejedrejtimit ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë

Ornela Manjani

Isaraj: Konvertimi patentës, pas paraqitjes së kërkesës

Rinovimi i lejes, vetëm me raport dhe foto

Kreu i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor Arben Isaraj ka shpejtuar dje procedurën që duhet të ndjekin shtetasit shqiptar për të konvertuar në shtetin grek lejen e drejtimit të mjetit. Madje Isaraj ka shpjeguar edhe procedurën për rinovimin e lejes së drejtimit, e cila kërkon vetëm 10 minuta kohë, një raport mjeko-ligjor dhe një fotografi. Kreu i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor bën të ditur se edhe shtetasit shqiptarë mund të udhëtojnë në Greqi me patentën shqiptare, por për të realizuar këtë duhet më parë të presim një datë të dytë kur të hyjë në fuqi vendimi. Sipas Isarajt njohja dhe konvertimi i lejeve të drejtimit ndërmjet shtetit shqiptar dhe shtetit Grek është vendosur me VKM-në Nr. 479, datë më 31.07.2018, është miratuar Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, "Mbi njohjen e Ndërsjellë të Lejeve të Drejtimit". Në një postim në "Facebook" Isaraj bën të ditur se në momentin që shtetasit shqiptar vendosin rezidencën normale në shtetin grek, ata mund të konvertojnë lejedrejtimin shqiptar, në lejedrejtimin grek, duke paraqitur kërkesën e tyre pranë Drejtorive të Transportit dhe Komunikimit të Rajoneve të Njësjeshe Rajonale në shtetin grek, pas kryerjes së kontrolleve mjekësore që vërtetojnë se personi është i aftë fizikisht të drejtojë një mjet motorik ose një kombinim të mjetve të kategorisë specifike, si dhe të sigurojë një përkthim zyrtar të lejes së drejtimit greke, në gjuhën shqipe, pa qenë e nevojshme kryerja e testeve teorike dhe praktike. Për konvertimin e lejedrejtimit shqiptar në lejedrejtimin grek, mbajtësit e saj duhet të kenë moshën e parashikuar në legjislacionin e shtetit grek. "Në momentin që shtetasit grek vendosin rezidencën normale në territorin shqiptar, ata mund të konvertojnë lejedrejtimin grek, në lejedrejtimin shqiptar, duke paraqitur kërkesën e tyre pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor të shtetit Shqiptar, pas kryerjes së kontrolleve mjekësore që vërtetojnë se personi është i aftë fizikisht të drejtojë një mjet motorik ose një kombinim të mjetve të kategorisë specifike, si dhe



Kreu i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Arben Isaraj

NJOHJA RECIPROKE E LEJEVE TË DREJTIMIT

■ Shtetasit shqiptarë, mbajtës të lejedrejtimit shqiptar, Modeli I (lëshuar nga data 01.07.2005) ose Modeli II (lëshuar nga data 24.01.2017), mund të drejtojnë mjete në territorin grek, brenda periudhës së vlefshmërisë së lejedrejtimit, për sa kohë nuk kanë vendosur rezidencën normale në shtetin Grek.

■ Shtetasit grekë, mbajtës të lejedrejtimit grek Modeli I (lëshuar deri më 11 janar 1987), Modeli II (lëshuar nga data 12 janar 1987 deri më 31 mars 1997), Modeli III (lëshuar nga data 01 prill 1997 deri më 30 prill 2001), Modeli IV (lëshuar nga data 02 maj 2001 deri më 18 janar 2009), Modeli V (lëshuar nga 19 janar 2009 deri më 18 janar 2013), Modeli VI (lëshuar nga 19 janar 2013), mund të drejtojnë mjete në territorin shqiptar me lejedrejtimet kombëtare të lëshuara nga shteti grek, brenda periudhës së vlefshmërisë së lejedrejtimit, për sa kohë nuk kanë vendosur rezidencën normale në shtetin Shqiptar.

të sigurojë një përkthim zyrtar të lejes së drejtimit greke, në gjuhën shqipe, pa qenë e nevojshme kryerja e testeve teorike dhe praktike. Për konvertimin e lejedrejtimit grek në lejedrejtimit shqiptar, mbajtësit e saj duhet të kenë moshën e parashikuar në legjislacionin e shtetit shqiptar - shkruan Isaraj.

MARRËVESHJA

Në nenin 1 të marrëveshjes parashikohet që secila palë kontraktuese konverton lejet e drejtimit të vlefshme (përveç lejeve të drejtimit të përkohshme, në periudhë prove dhe të llojeve të ngjashme) të lëshuara nga pala tjetër kontraktuese në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm,

në rastin kur mbajtësit e lejeve të tilla të drejtimit u është dhënë rezidenca normale në territorin e palës përkatëse kontraktuese. Palët kontraktuese njohin për drejtimin e mjetve në territorin e tyre edhe lejet kombëtare të drejtimit të lëshuara nga pala tjetër kontraktuese brenda periudhës së tyre të vlefshmërisë, përveç

nëse përbushen dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni. "Leja e drejtimit e lëshuar nga autoritetet kompetente të secilës palë kontraktuese pushon së qeni e vlefshme për drejtimin e mjetve në territorin e palës tjetër kontraktuese nga data në të cilën mbajtësit e një leje të tillë drejtimi i jepet rezidenca normale në atë palë

tjetër kontraktuese. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, termi "rezidenca normale" ka kuptimin që i jepet atij nga legjislacioni i brendshëm përkatës i palëve kontraktuese. Nëse mbajtësi i një lejeje drejtimi të lëshuar nga autoritetet kompetente të secilës palë kontraktuese i është dhënë rezidenca normale në territorin e palës tjetër kontraktuese, autoritetet kompetente të asaj pale tjetër kontraktuese konvertojnë lejen pa kërkuar kryerjen e testeve teorike dhe praktike. Autoritetet kompetente të palës kontraktuese që kryejnë konvertimin kërkojnë një vërtetim mjekësor, i cili vërteton se një person është i aftë fizikisht të drejtojë një mjet motorik ose një kombinim të mjetve të kategorisë specifike. Për zbatimin e paragrafit të parë të këtij neni, mbajtësit e lejeve të drejtimit duhet të kenë moshën e parashikuar nga legjislacionet e brendshme kontraktuese për lëshimin e kategorisë për të cilën kërkojnë konvertimin" - thuhet në marrëveshje.

Ministria e Financave zbardh shpenzimet për zyra dhe orendi pas zgjedhjeve 2017

Ministria e Financave dhe Ekonomisë bën të ditur të dhënat për ecurinë e shpenzimeve publike, midis të cilave edhe ato për rikonstrukcione, pajisje dhe mobilim për zyrat e administratës, të cilat sipas të dhënave paraprake të shtatëmuorit janë në shifrën 621.86 milionë lekë ose vetëm 2.78% e realizimit faktik të investimeve të brendshme, ndryshe nga shifra e pretenduar në disa "pseudo-analiza" të bëra me qëllim të tjerë përtej realitetit të buxhetit të shtetit. Konkretisht, për muajin e shtatë të vitit 2018 (të dhëna paraprake) është konstatuar

PËR VITIN 2018

1. Plani i shpenzimeve për rikonstrukcione, pajisje dhe mobilim për zyrat e administratës për vitin 2018 është 990 milionë lekë ose vetëm 1.79% e totalit të investimeve të brendshme.
2. Fakti i shpenzimeve për rikonstrukcione, pajisje dhe mobilim për zyrat e administratës si 7-mujor rezultoi 621.86 milionë lekë ose vetëm 2.78% e realizimit faktik të investimeve të brendshme.

një realizim në masën rreth 34.7 miliardë lekë ose rreth 88.3 përqind, në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë në buxhetin fillestar 2018. Respektivisht, projektet e investimeve me financim të brendshëm kanë shënuar një realizim faktik total në masën rreth 22.3

miliardë LEK ose 95.8 përqind të planit të periudhës, ndërkohë që ato me financim të huaj kanë shënuar një realizim në masën rreth 12.1 miliardë lekë ose rreth 76.9 përqind të planit të periudhës. Kundrajt planit vjetor 2018, për 7 muajorin janar-korrik është konstatuar



korrik 2018, rezultoi se: Shpenzimet për "Pajisje dhe mobilim zyresh për vitin 2018 janë planifikuar në masën 342.1 milionë lekë ose vetëm 0.6% të totalit vjetor të investimeve të brendshme prej 55.17 miliardë lekë. Për periudhën 7-mujore ato janë realizuar në nivelin faktik prej 76.3 milionë lekë ose 22.3% e planit, kundrejt nivelit faktik të totalit të investimeve të brendshme prej 22.3 miliardë lekë; shpenzimet për "Rikonstrukcion ndërtim zyresh", për vitin 2018 janë planifikuar në masën 647.8 milionë lekë ose vetëm 1.17% të totalit vjetor të investimeve të brendshme prej 55.17 miliardë lekë. Për periudhën 7-mujore ato janë realizuar në nivelin faktik prej 545.5 milionë lekë ose 84.2% e tij, kundrejt nivelit faktik të totalit të investimeve të brendshme prej 22.3 miliardë lekë.

SHPLLJE ANKANDI
Datë 23.08.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com

Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajshme të debitorit Enkelea Novaku dhe dorëzuesit Adriatik Novaku:

"Trruall" me sipërfaqe 100 m² dhe "Ndërtesë" me 3 kato me sipërfaqe 90 m² secili, nr. i pasurisë 4106, zona kadastrale 8581, vol. 13, faqe 69, adresa: Lagja Nr. 1, Pogradec. Cmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 7 280 000 (shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPLLJE ANKANDI
Datë 21.08.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com

Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajshme të dorëzuesit Petrit Sami Sina dhe Majlinda Xhavit Sina:

"Apartamenti" me sipërfaqe 54 m², nr. i pasurisë 1126+1-7, zona kadastrale 2932, vol. 14, faqe 26, adresa: Lagja "Gjakë Dog", Peshkopi, Dibër.

Cmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 1 600 000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Përmbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të Dytë për pasuritë e paluajshme si më poshtë:

- Pasuria Nr. 2503+1-2, Vol.-31, fq.-234, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m², ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë \$ 284 440 Lekë.
- Pasuria Nr. 2503+1-3, Vol.-31, fq.-235, Z.k-1791, Apartament me Sip.-209.7 m², ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë \$ 284 440 Lekë.
- Pasuria Nr.21111, Vol.-4, fq.-201, Z.k-1791, Iloji Tokë-04/Rë, me Sip.- 500 m², ndodhur në Golem Kavajë, me vlerë 280 000 Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 23.08.2018 në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati -2, Tiranë. Cel. 069 723 0003, email: medar.kajolli@yahoo.com

SARANDE - Një gomone e braktisur është gjetur mëngjesin e djeshëm në grykëderdhjen e Bistricës në zonën e fshatit Çukë, Bashkia Sarandë. Nga të dhënat paraprake, mësohet se mjeti lundrues i është vjedhur në Greqi një shtetaseje italiane. Burime konfidenciale bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se gomonia me mbishkrimin "Twentythree" dhe "Marco", i cili mund të jetë dedikim për dikë që ka lidhje



Gomonia e sekuestruar nga policia

Mjeti lundrues u vodh në ishullin Paxos të Korfuzit

Blokohet gomonia në grykëderdhjen e lumit Bistricë, dyshohet se do përdorej për trafik

me pronaren e gomones së shtetases italiane, dyshohet të jetë vjedhur mbrëmjen midis 13-14 gushtit në ishullin Paxos të Korfuzit. Menjëherë policia ka shkuar në vendin ku edhe ndodhet mjeti lundrues, ku pjesa e fundit e saj është e

zhytur, por lëvizja e mjetit prej aty është shumë e vështirë. Kjo pasi personat që e kanë vjedhur i kanë marrë edhe motorin, ndërsa gomonia rreth 7 metra e gjatë ka futur ujë. Një nga pistat paraprake për të cilat po heton

policia është ajo se gomonia mund të jetë përdorur nga trafikantët për transport droge dhe më pas është braktisur. Hetimet vijnë për identifikimin dhe kapjen e personave që fshihen pas ngjarjes.

Gjykata e Krimeve të Rënda lë në burg pa afat 21-vjeçarin Sebastian Vall

U arrestua me 19 pistoleta në Muriqan, suedezi: Po bëja vetëm transportin

TIRANË

Gjykata e Krimeve të Rënda në Tiranë dje vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj suedezit Sebastian Vall, i cili më 13 gusht të këtij viti u kap në doganën e Muriqanit me 19 pistoleta tekta po udhëtonte si pasagjer me autobus drejt Malit të Zi. "Unë do bëja vetëm transportin e pistoletave nga Shqipëria për në Suedi", është shprehur në sallën e gjyqit 21-vjeçari. Gjatë fjalës së tij, i riu suedez tha se kishte udhëtuar me avion nga Suedia drejt Kosovës me një linjë transit nga Turqia. "Unë do të bëja transportin. Kam qëndruar katër ditë në Prishtinë ku edhe bleva pistoletat tek një person që nuk ia dija emrin. Do të kthehesha në Suedi në rrugë tokësore, fillimisht me linjë autobusi nga Kosova në Gjermani dhe më tej në Suedi. Kisha nevojë për para, pasi isha i papunë. Doja të studioja, por nuk kisha mundësi, ndaj dhe e kreu këtë akt", ka deklaruar Sebastian Vall. Ndërkaq, gjatë seancës prokurori Vladimir Mara u shpreh se nga hetimet rezultoi se 21-vjeçari ka udhëtuar në rrugë ajrore nga Suedia në Prishtinë, duke kaluar transitin në Turqi. Në kryeqytetin e Kosovës ai ka qëndruar katër ditë, ku edhe ka marrë ngarkesën e armëve. "Drejt Suedisë, i dyshuari ka vendosur të kthehet në rrugë tokësore, me autobusin e linjës Kosovë-Gjermani. Në pikën e kalimit kufitar, në Muriqan gjatë një kontrolli rastësor u zbulua ngarkesa me armë që i përkiste shtetasit suedez", pohoi përfaqësuesi i akuzës. Përpara grupit të hetuesve, i riu ka deklaruar se do të bënte transportin e armëve kundrejt një shume parash, por pa dhënë detaje të mëtejshme. Ai ka refuzuar të zbulojë bashkëpunëtorët, duke pretenduar se si personin që i dorëzoi armët, ashtu edhe pritësin e tyre, nuk i njohte. Avokati Stefan

"E bëra për para, pasi dua të studioj"

Topalli kërkoi që ndaj të dyshuarit të caktohej një masë sigurie me afat, derisa të identifikoheshin bashkëpunëtorët e tij. Pasi dëgjoji palët, gjykata vendosi lënie në burg pa afat suedezit, i cili akuzohet për trafik ndërkombëtar të armëve, kryer në bashkëpunim. Për arrestimin e 21-vjeçarit prokurori tha se është informuar ambasada suedeze në Tiranë, por në sallën e gjyqit nuk ishte i pranishëm asnjë përfaqësues i saj. Mësohet se 21-vjeçari Sebastian Vall është kontaktuar nga përfaqësues të ambasadës në ambientet e parburgimit.



Pistoletat e sekuestruara në Muriqan

Shpërthen gazi në magazinën e çerdhës, panik mes prindërve

TIRANË - Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, çerdhja nr.14 në zonën e "Ali Demit" në Tiranë u trondit nga një shpërthim që hodhi në tokë një pjesë të saj. Policia sqaroi se shkak u bë rrjedhja nga një bombol gazi që mbahej në ambientet e pasme të ndërtesës. Shpërthimi u shoqërua me një zjarr që shkaktoi vetëm dëme materiale. Policia dhe forcat e zjarrfikëse kanë shkruar menjëherë në vendngjarje dhe kanë ndërhyrë për shuarjen e flakëve. Sipas njoftimit të policisë, thuhet se zjarri ka rënë në një dhomë, e cila shërbente si magazinë. "Rreth orës 04:57, në rrugën 'Ali Demit', në një dhomë e cila shërbente si magazinë për një çerdhë ka pasur rënie zjarri. Menjëherë zjarri është fikur dhe ka pasur vetëm dëme të vogla materiale. Paraprakisht, zjarri dyshohet të ketë rënë si pasojë e rrjedhjes së gazit nga një bombol gati", thuhet në njoftimin e policisë. Drejtoresha e çerdhëve në Tiranë, Zhaneta Beqiri u shpreh se magazina është jashtë ambienteve të çerdhës nr.14. "Ka një disinformim për një ngjarje që ka ndodhur ngjitur me godinën e çerdhës dhe jo në godinën e çerdhës. Aktiviteti vazhdon normal dhe konform parametrevë. Sa i përket sigurisë së elementeve të shërbimit dhe në rastin konkret bombolave të gazit, ato janë me certifikatë", u shpreh Beqiri. Ndërkaq, ajo theksoi se çerdhët në Tiranë punojnë me soba me gaz, ndërsa nuk përjashtoi tentativën e një zjarrvënije të qëllimshme.

Në pranga edhe 26-vjeçari Gerald Keta

Kontrabandë mallrash nga Rinasi, arrestohet doganieri Geron Hoxha

RINAS - Policia kufitare e Rinasi ka arrestuar një 26-vjeçar, pasi ka tentuar të kalojë mallra kontrabandë. Ndërkohë që ka përfunduar në pranga edhe një doganier, i cili akuzohet se ka shpërdoruar detyrën duke lejuar që të kalonte mallrat kontrabandë. Burime zyrtare nga policia dje bënë me dije se shtetasit e arrestuar janë: Gerald Keta, 26 vjeç, banues në Tiranë si dhe Geron Hoxha, 29 vjeç, banues në Tiranë me detyrë doganier në doganën Rinasi. Sipas bluve, arrestimi i tyre u bë pasi shtetasi Gerald Keta, në doganën e Rinasi tentoi të kalonte mallra kontrabandë (veshje) në mënyrë të kundërligjshme, ndërsa shtetasi Geron Hoxha (me detyrë doganier), në



kundërshtim me ligjin dhe duke keqpërdorur atributet që i jep detyra, ka shpërdoruar detyrën duke lejuar që të kalonte mallrat kon-

trabandë shtetasi i mësipërm. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale: "Kontrabandë me

ARRESTIMI

Sipas bluve, arrestimi i tyre u bë pasi shtetasi Gerald Keta, në doganën e Rinasi tentoi të kalonte mallra kontrabandë (veshje) në mënyrë të kundërligjshme, ndërsa shtetasi Geron Hoxha (me detyrë doganier), në kundërshtim me ligjin dhe duke keqpërdorur atributet që i jep detyra, ka shpërdoruar detyrën duke lejuar që të kalonte mallrat kontrabandë.

mallra të tjerë", parashikuar në ngarkim të Ketës dhe për veprën penale "Shpërdorim detyre" në ngarkim të doganierit Hoxha.

Admir Murataj: Gruaja tentoi t'i mbyste të bijat me thonj në sy të policisë

Nëna tentoi të mbytej në lumë me vajzat binjake, i riu: Ja si ia hoqa fëmijët nga duart

"Njërës prej vajzave i bëra frymëmarrje artificiale, u ndjeva i shokuar, ato ishin dy engjëj e shumë të bukura"

FIER

Në i ri i papunë, i cili po peshkonte në ujërat e lumit Seman ka shpëtuar vajzat binjake të 42-vjeçarës Rudina Kishta, e cila në gjendje të rënduar psikike tentoi të mbyste 6-vjeçarët. Pak ditë pas ngjarjes së rëndë, Admir Murataj tregoi me detaje se si i shpëtoi dy të miturat. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Murataj u shpreh se 42-vjeçarja tentoi të mbyste së bashku me të bijat. "U hodha direkt në lumë dhe notova në drejtim të tyre. Njërën nga vajzat e kam nxjerrë nga lumi pa ndjenja dhe i kam bërë frymëmarrje artificiale. Në lum u hodh edhe një peshkatar tjetër që ndodhej aty për të shpëtuar nënën dhe dy fëmijët e saj. U ndjeva i shokuar, pasi vajzat ishin si engjëj dhe shumë të bukura", tha "heroi" nga Fieri. Ndërkohë, Admir Murataj pohoi se pasi doli gruaja në breg, tentoi t'i mbyste me thonj vajzat e saj, edhe pse aty mbërriti policia. Vetëm dy ditë më parë Gjykata e Shkallës së Parë e Fierit vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Rudina Kishtës, e cila akuzohet se dogji shtëpinë e bashkëjetuesit të saj, Ardian Gjika e më pas tentoi të mbyste dhe dy vajzat. E pandehura shokoi me deklaratën e saj në sallën e gjyqit. Ajo tha se "vajzat do t'i mbysja se janë të miat".



Admir Murataj, duke folur për "GSH"



42-vjeçarja Rudina Kishta

DEKLARATA SHOKUESE E GRUAS

Dy ditë më parë Gjykata e Shkallës së Parë e Fierit vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Rudina Kishtës, e cila akuzohet se dogji shtëpinë e bashkëjetuesit të saj, Ardian Gjika e më pas tentoi të mbyste edhe dy vajzat. 42-vjeçarja u shpreh në sallën e gjyqit se, "unë ia kam vënë flakën shtëpisë, sepse bashkëjetuesi im prej 6 muajsh më rrihte mua dhe dy vajzat e mia". Jo vetëm kaq, por Kishta shokoi me deklaratën e saj para togave të zeza. Ajo tha se "vajzat do t'i mbysja se janë të miat".

Admir, mund të na thoni si i shpëtuan vajzat binjake dhe si e përjetuat atë moment?

Unë isha duke peshkuar në lumë dhe shoh një grua me dy kalamaq, që vjen në krahu tjetër të urës matanë. Duke ecur avash-avash, ajo u hodh direkt në lumë. Njërën vajzë e kishte në krah, ndërsa tjetrën e kapri për flokësh dhe filloi ta zhysë në ujë. Në moment unë u zhyta në lumë dhe notova disa metra për të kaluar në krahu matanë, ku thellësia mund të jetë më shumë se tri metra. Kam ecur me not dhe i kam hequr njërën gocë nga duart, ndërsa gocën tjetër e kishte kapur për flokësh dhe e kishte zhytur me kokë në ujë. Kur e nxora nga uji, pashe se vajza ishte e mbytur komplet. I kam bërë frymëmarrje artificiale pasi e nxora nga uji dhe e shpëtova. Më pas ka reaguar edhe një peshkatar i komunitetit rom, i cili shpëtoi gruan. Pasi doli, gruaja donte t'i mbyste fëmijët me thonj. Në lajmëruam policinë dhe gruaja sërisht tentoi të mbyste fëmijët edhe në sy të policisë. Jam i lumtur që shpëtova dy engjëj. Nuk e ndiej veten hero, mund ta bënte gjithkush.

Gruaja donte të mbytej edhe vetë?

Po, normale donte të mbytej bashkë me vajzat.

Ajo u zhyt me dy fëmijët prapë.

Dëgjuat të thoshte ndon-

jë gjë?

Jo, nuk dëgjova asgjë.

Ajo thoshte fëmijët janë të

mitë dhe do bëj çfarë të dua. Më lini se do i mbys. Ato ishin dy engjëj dhe ishin shumë

Arrestohet për vjedhje energjie edhe kryeplaku i Melgushës

Faturonte hotelin me 340 lekë, përfundojnë në pranga punonjësi OSHEE-së dhe pronari i hotelit

LEZHË - Forcat e policisë dhe ekipet e Task Forcë të Drejtorisë Rajonale OSHEE Shkodër kanë arrestuar një punonjës të OSHEE në Lezhë si dhe pronarin e një hoteli, pasi akuzohen për vjedhje të energjisë elektrike, duke manipuluar matësin. Nga hetimet e kryera rezultoi se punonjësi i OSHEE, lexuesi Gëzim M. në bashkëpunim me punonjës të tjerë (nën hetim për ndarjen e përgjegjësive), faturonte me 340 lekë në muaj hotel "Brillant" në Shëngjin. Objekti, me kontratë në pronësi të Mhill N. nuk faturonhej, pasi ishte manipuluar matësi, duke shkaktuar dëm në vlera disa milionë lekë. Dosja me procesverbalin përkatës është dorëzuar prokurorisë për ndjekje penale, ndërsa ndaj shtetasve ka nisur procedim penal. Punonjësi i OSHEE është sh-



karkuar nga detyra, kurse hotelit i është ndërprerë energjia elektrike. Ndërkaq, ka përfunduar në pranga Isa Ç., pasi kishte ndërhyrë në matës duke vjedhur energji elektrike. Abonenti, i cili është kryeplaku i fshatit Malgush, Vau i Dejës, kishte krijuar një debi rreth 6 milionë lekë. Ndaj tij u mor masa e procedimit penal, bazuar mbi të dhënat e

testimit, provat dhe procesverbalet e grupit të verifikimit të OSHEE së OSHEE bën me dije se është e detyruar të përsërisë faktin se askush nuk procedohet në polici se është debitor ndaj faturave, por në zbatim të nenit 137 të Kodit Penal ndëshkohen ata persona që vjedhin energjinë elektrike dhe dëmtojnë matësin. Gjithashtu, "çdo ndërhyrje tjetër e paligjshme dhe e paautorizuar në sistemin e matjes apo në rrjetin elektrik, me qëllim përfitim të paligjshëm, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim deri në tre vjet", thuhet në nenin 137. Kur kjo veprë penale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose nga përdoruesit jofamiljarë të energjisë elektrike ose të rrjetit të shërbimit telefonik, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Iu gjet hashash në makinë, kapet në port italian 60-vjeçar

DURRËS - Policia kufitare në Portin e Durrësit ka arrestuar mbrëmjen e së mërkurës një shtetas italian, pasi ka tentuar të trafikojë 6 kg e 105 gr marijuanë drejt Italisë. Mësohet se gjatë kontrollit të intërsishëm të ushtruar në vijën e dytë në mjetin tip "Fiat", në pjesën e poshtme të mbrapakolpit u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale sasia e drogës. Policia arrestoi në flagrancë 60-vjeçarin Piero Mormina, banues në Itali. Materialet në ngarkim të shtetasit italian i kaluan për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale "Trafikimi i lëndëve narkotike". Pritet që gjykata të vendosë masën e sigurisë ndaj tij.

të bukura.

Vetë vajzat kërkonin ndihmë?

Ato po qanin dhe thoshin mos më largoni nga mami. Duam mamin.

Ju si u ndjetë që patë këtë skenë?

U ndjeva i shokuar. Të shohësh dy engjëj që mbyten...

Ju për çfarë vini këtu?

Thjesht për të peshkuar, sepse jam i papunë.



E zë poshtë bombola e madhe e oksigjenit që përdorej nga gjyshi, vdes 3-vjeçari

KORÇË - Një fëmijë 3 vjeç ka humbur jetën në mënyrë tragjike në fshatin Mborje të Korçës. Ngjarja ndodhi mesditën e djeshme, kur fëmija me inicialet J.D. ishte në shtëpi së bashku me të ëmën. Sipas familjarëve, vogëlushi ka shkuar në dhomën e gjyshit, në të cilën ndodhej një bombol oksigjeni. Mësohet se bombola përdorej nga gjyshi i tij, i cili vuan nga astma. Fëmija ka prekur bombolën (ishte e përmasave të mëdha dhe me peshë të konsiderueshme), e cila ka rrëshqitur duke e zënë atë poshtë. "Rreth orës 11:25, në fshatin Mborje-Korçë, në banesë, shtetasit J.D., rreth 3 vjeç, dyshohet se duke luajtur, aksidentalisht i ka rënë duke e zënë poshtë një bombol gazi e madhe, e cila për pasojë i ka shkaktuar dëmtime trupore këtij të fundit. Ky shtetas u shoqërua në Spitalin e Korçës nga familjarët e tij, ku më pas ka ndëruar jetë. Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes", - thuhet në njoftimin e policisë.

Tabela/ Vëzhgimi, prindërit do të paguajnë deri në 35% më shumë krahasuar me 2017-ën

Voltiza Duro

Rritje e çmimeve të teksteve shkollore të parauniversitarit

Sa lekë më shumë do të shpenzoni për Matematikën e Anglishten

Edhe pse nxënësit nga klasa e parë deri në të katërt do i marrin falas tekste këtu vit të ri mësimor, çmimet e librave për klasat e tjera ta parauniversitarit kanë pësuar rritje krahasuar me një vit më parë. Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë ka publikuar katalogun final të teksteve shkollore në faqen e saj zyrtare për vitin mësimor 2018-2019, në të cilin vihet re një rritje e çmimit nga 2-35% më shumë. Kështu teksti i Gjuhës Shqipe për klasën e VI, vjet kushtonte 529 lekë, ndërsa këtë vit prindërit do e blejnë 10 lekë më shumë, pra 539 lekë. Ndërkohë, Matematika për vitin 2018-2018, do të kushtojë 586 lekë nga 513 lekë që ka qenë një vit më parë, ndërkohë Biologjia nga 208 lekë do të kushtojë 242 lekë më shumë, pra 250 lekë. Nëse në vitin 2017-2018 historia e klasës së 6 kushtonte 214 lekë këtë vit ajo shitet 218 lekë po ashtu Fizika nga 243 lekë vjet, prindërit duhet ta blejnë 247 lekë, e po njësoj edhe teksti i lëndës Teknologji Informacion Komunikim. Një rritje e lartë çmimi prej 183 lekësh vihet re te teksti i anglishtes së klasës së gjashtë, i cili vitin e kaluar ka qenë 893 lekë ndërsa sivjet do të shitet me 1076 lekë. Sipas vëzhgimeve dhe krahasimeve me vitin e kaluar, këtë rritje e kanë pësuar të gjithë librat duke rritur çmimin e paketës e cila për klasat e 6 - ta në vitin shkollor 2017-2018 kushtonte 3964 lekë në total, ndërsa këtë vit arrin në 4298 lekë ose 325 lekë më shumë. Edhe teksti i lëndës së Gjeografisë ka pësuar një rritje prej 20 lekësh, pra nga 292 lekë që u tregtua një vit më parë, për 2018-2019 prindërit do të duhet ta blejnë me 312 lekë. ndërkaq, edhe teksti i Artit Pamor nga 167 lekë që është marrë një vit më parë, do të kushtojë 170 lekë këtë vit.

TREGTIMI

Ndërkohë edhe për këtë vit



Foto ilustruese

RRITJA E ÇMIMEVE PËR KLASËN E VI

Lënda Viti 2017-2018	Viti 2018-2019
Gjuhë Shqipe	529 lekë 539 lekë
Matematikë	513 lekë 586 lekë
Fizikë	243 lekë 247 lekë
Biologji	208 lekë 250 lekë
Qytetari	195 lekë 203 lekë
Art pamor	167 lekë 170 lekë
Muzikë	165 lekë 164 lekë
Anglisht	893 lekë 1076 lekë
Anglisht fletë pune	164 lekë 164 lekë
Teknologji informacion	243 lekë 247 lekë
Histori	214 lekë 218 lekë
Aftësim teknologjik	138 lekë 140 lekë
Gjeografi	292 lekë 312 lekë

prindërit do të kenë mundësi të blejnë librat për fëmijët e tyre 10 ditë para nisjes së shkollës pranë njësitve tregtare të shitjes së librave ose pika të tjera shitjeje pranë shkollave nga subjekte të licencuara.

Sipas urdhrorit të publikuar tashmë nga ministria e Arsimit, subjekteve të licencuara për shitjen e librave shkollor nuk do ti lejohet që ti shesin nxënësve libra të cilët nuk janë pjesë e katalogut.

RRITJA

Një rritje e lartë çmimi prej 183 lekësh vihet re te teksti i Anglishtes së klasës së gjashtë, i cili vitin e kaluar ka qenë 893 lekë ndërsa sivjet do të shitet me 1076 lekë. Sipas vëzhgimeve dhe krahasimeve me vitin e kaluar, këtë rritje e kanë pësuar të gjithë librat duke rritur çmimin e paketës, e cila për klasat e 6 - ta në vitin shkollor 2017-2018 kushtonte 3964 lekë në total, ndërsa këtë vit arrin në 4298 lekë



Tekste shkollore falas për nxënësit e klasave I-IV

Me fillimin e vitit mësimor 2018-2019, të gjithë nxënësit e klasave I-IV të arsimit bazë do ti përfitojnë falas teksteve shkollore, me kushtin që duhet ti dorëzojnë sërish pas përfundimit të vitit. "Tekstet shkollore të klasave I-IV, të cilat janë pronë e njëjësve arsimore vendore, të përdoren për një periudhë kohore deri në tri vite shkollore. Njësitë arsimore vendore dhe drejtoritë e shkollave publike janë strukturat përgjegjëse për pajisjen me tekstet shkollore në përdorim falas të të gjithë nxënësve të klasave I-IV në shkollat e varësisë", theksohet në udhëzimin. Më tej në këtë të fundit bëhet me dije se drejtori i shkollës publike ngre Komisionin e Administrimit të Teksteve Shkollore në përdorim falas, si strukturë që kryen të gjithë veprimtarinë e marrjes në dorëzim të teksteve shkollore, sipas porosisë së dhënë, kthimit dhe rishpërndarjes të nxënësve. Komisioni do të kryesohet nga drejtori i shkollës, ndërsa numri i anëtarëve do të përcaktohet në varësi të numrit të nxënësve për klasat I-IV në shkollë, por jo më pak se dy anëtarë.

BLERJA E TEKSTEVE

Ndërkohë edhe për këtë vit prindërit do të kenë mundësi të blejnë librat për fëmijët e tyre 10 ditë para nisjes së shkollës pranë njësitve tregtare të shitjes së librave ose pika të tjera shitjeje pranë shkollave nga subjekte të licencuara.

FOTOLAJMI ! PERFUNDON NDERTIMI I RRUGES "FAIK KONICA" NË KRYEQYTET



Bashkia e Tiranës përfundoi dje ndërtimin e rrugës 'Faik Konica', segmenti që lidh stadiumin "Qemal Stafa" me Fakultetin e Gjeologjisë, e cila tashmë do të shërbejë edhe si pedonale. Ndërsa inspektoji punimet e kryera në këtë rrugë, Veliaj u shpreh se ndërtimi i kësaj rruge tregon edhe një herë se sa herë që bashkia ndërhyr për të investuar, sjell ndryshim për të gjithë komunitetin.

Tel.: (+355-4) 4500015
4500016
4500017
Fax: (+355-4) 4500018

VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNFPA office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

Post Title: Driver
Duty station: Tirana, Albania
Type of Contract: SC
Work Experience: A minimum of three years work experience as a driver in an international organization, embassy or UN system with a safe driving record.
Language: Good knowledge of English Language

Deadline for Application: 31 August, 2018 5:00 p.m.

Job Description: Available at the UNFPA site <http://albania.unfpa.org>

Interested and qualified candidates should submit the following documents:

- A letter of interest.
- An updated P11 Form.
- Copies of supporting documents, to the following address:

UNFPA Office
UN House Str. "Skenderbej"
Gurten Building, Second Floor
Tirana, Albania
albania.office@unfpa.org

AKU: Mbyllet subjekti, gjobë prej 350 mijë lekësh Blokohen 120 kg djathë në Shkodër, tregtim në kushte të rënda higjieno-sanitare

120

KG DJATHË KONFISKOHET

Ndaj subjektit të sipërpërmendur u mor masa administrative me gjobë prej 350 mijë lekësh, u vendos mbyllja e aktivitetit si dhe u bë bllokimi i sasisë së produktit "djathë i bardhë" prej 120 kg, si dhe u morën mostra për analiza.

L56411014T, dhe aktivitet "Përpunim qumësht, Baxho" kryer veprimtari në kundërshtim me standardet e sigurisë ushqimore duke ruajtur produktin djathë në ambient frigoriferik me përmbytje myku si dhe temperatura e trajtimit të qumështit nuk

ishite në normat e lejuara", - thuhet në njoftimin e AKU-së. Ndaj subjektit të sipërpërmendur u mor masa administrative me gjobë prej 350 mijë lekësh, u vendos mbyllja e aktivitetit si dhe u bë bllokimi i sasisë së produktit "djathë i bardhë" prej 120 kg, si dhe u

morën mostra për analiza. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore, i bën thirrje edhe operatorëve të biznesit ushqimor (njësive të tregtimit e shërbimit) që të jenë të kujdesshëm në blerjen e lëndëve të para, produkte sh-



tazone dhe jo shtazore duke kërkuar e marrë nga furnitorët vetëm produkte me etiketë dhe të shoqëruara dokumentacion të plotë veterinar e fiskal - pasi është një detyrim ligjor i tyre përveçse përbën një masë tepër të rëndësishme për sigurinë ushq-

more të klientëve të tyre. Gjithashtu, AKU inkurajon të gjithë qytetarët të denoncojnë çdo rast, çdo tentativë abuzimi, pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në info@aku.gov.al si dhe pranë portallit të bashkëqeverisjes "Shqipëria që duam".

"Kujdes, nuk mund të punoni apo të qëndroni më shumë se 6 muaj në Amerikë"

Voltiza Duro

Vizat turistike në SHBA, nuk duhet garanci financiare

Ambasada: Vendimet bazohen tek intervista me oficerin konsullor

Të interesuarit për viza turistike drejt Shteteve të Bashkuara, nuk do e kenë të nevojshme pajisjen me një garanci financiare apo dokumente të tjera gjatë aplikimit. Kjo është ajo çka kanë deklaruar dje ekspertët e ambasadës amerikane në Tiranë, të cilët më tej kanë theksuar se vendimet bazohen te intervista. "Nuk kemi nevojë për garanci financiare ose dokumente të tjera në mbështetje të aplikimit tuaj për vizë turistike për në Shtetet e Bashkuara. Vendimet tona bazohen tek intervista, ndaj ejani të përgatitur për t'u përgjigjur disa pyetjeve dhe lërimi dokumentet në shtëpi!", theksohet në njoftim.

APLIKIMI

Për vizë vizitori B1/B2 aplikantit duhet të paraqesë vetëm pasaportën, një kopje të printuar të fletës së konfirmimit të aplikimit elektronik DS-160 dhe një foto me ngjyra 5cm X 5cm të nxjerrë kohët e fundit, e cila duhet të përbushë të gjitha kërkesat. Nuk nevojiten dokumente të tjera e nuk nevojiten një ftesë. "Ju lutemi, mos sillni letra nga banka dhe dokumente të tjera që nuk janë kërkuar. Ato nuk do të shqyrtohen. Vetëm oficeri konsullor që ju merr në intervistë pasi të ketë shqyrtuar çështjen tuaj dhe t'u ketë intervistuar, ai do të marrë vendimin nëse gjendeni ose jo i kualifikueshëm", bëjnë me dije ekspertët e ambasadës. Gjithsesi, secili aplikant i vizës turistike duhet të tejkalojë prezumimin e qëllimit imigrues të aplikantit, pra që të dëshmojë që nuk është



Ambasada amerikane në Tiranë

KUJDES, JA PENALIZIMET

"Kini parasysh që viza turistike ka për qëllim një qëndrim për një kohë të shkurtër në SHBA. Viza turistike nuk është për të jetuar në SHBA dhe as për të punuar atje. Përndryshe, ju mund të gjendeni i papranueshëm sipas ligjit të imigracionit", - theksojnë ekspertët e ambasadës.

një imigrant i mundshëm, që ka lidhje të forta ekonomike e familjare me Shqipërinë dhe që do të kthehet sërish pas një qëndrimi të shkurtër në SHBA. Në faqen zyrtare në "Facebook", ambasada Amerikane shpjegon për aplikantët se nëse arrijnë të përzgjidhen tarifa e aplikimit për vizë për një person është 330 dollarë, vizita mjekësore shkollon 205 dollarë dhe pasi kandidati ka

marrë vizën 220 dollarë është shuma që duhet paguar për lëshimin e green card. Por, gjithashtu, bëhet me dije se këto tarifa mund të pësojnë ndryshime që nuk varen nga ambasada. Vetëm aplikimi për lotarinë është falas. **KOHA E QËNDRIMIT** Të gjithë personat që kanë marrë një vizë turistike për të udhëtuar në Shtetet e Bashkuara të Ame-

rikës duhet të kenë kujdes që të mos qëndrojnë më tepër se 6 muaj brenda një viti kohor. "Kini parasysh që viza turistike ka për qëllim një qëndrim për një kohë të shkurtër në SHBA - viza turistike nuk është për të jetuar në SHBA dhe as për të punuar atje. Përndryshe, ju mund të gjendeni i papranueshëm sipas ligjit të imigracionit", - theksojnë ek-

SI BËHET APLIKIMI?

- Vizitori B1/B2 aplikantit duhet të paraqesë vetëm pasaportën, një kopje të printuar të fletës së konfirmimit të aplikimit elektronik DS-160 dhe një foto me ngjyra 5cm X 5cm të nxjerrë kohët e fundit, e cila duhet të përbushë të gjitha kërkesat.
- Nuk nevojiten dokumente të tjera e nuk nevojiten një ftesë.
- Secili aplikant i vizës turistike duhet të tejkalojë prezumimin e qëllimit imigrues të aplikantit, pra që të dëshmojë që nuk është një imigrant i mundshëm, që ka lidhje të forta ekonomike e familjare me Shqipërinë dhe që do të kthehet sërish pas një qëndrimi të shkurtër në SHBA.
- Nëse aplikantët arrijnë të përzgjidhen tarifa e aplikimit për vizë për një person është 330 dollarë, vizita mjekësore shkollon 205 dollarë dhe pasi kandidati ka marrë vizën 220 dollarë është shuma që duhet paguar për lëshimin e green card. Por, gjithashtu, bëhet me dije se këto tarifa mund të pësojnë ndryshime që nuk varen nga ambasada. Vetëm aplikimi për lotarinë është falas.

spertët e ambasadës. Zyrarët e kufirit të Shteteve të Bashkuara përcaktojnë se sa kohë mund të qëndrojnë aplikantët në Shtetet e Bashkuara e për shumicën e mbajtësve të vizave të vizitorit (B1/B2), koha maksimale e qëndrimit është një muaj në vit kohor. Studentët, vizitorët e programeve të shkëmbimit dhe punëtorët e

përkohshëm janë në përgjithësi të pranuar për kohëzgjatjen e statusit (e shkruar "d/s" në pasaportë). Pavarësisht nga kjo, për të shmangur në të ardhmen problemet me vizën apo me hyrjen në Shtetet e Bashkuara, qëllimi dhe koha e qëndrimit në Shtetet e Bashkuara duhet të jetë në përputhje me çfarë individit ka thënë në aplikimin për vizë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHPLLJE ANKANDI

Më datë 15 tetor 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin I-rë, për shitjen e pasurisë nr.4/562/ND/N7, me çmim fillestar 7.695.000 lek.
Prona me sipërfaqe 95 m² i takon z.Sami Zeqir Zeqija, ajo ndodhet pranë dyqanit të ALBITAL-CANON, Rruga Egnatia,nr.4, Durrës.

P.s: Qytetarët/subjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të çmimit fillestar si garancë për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurohet duhet të jetë e derdher në BKT, nr.llogarisë Saimir Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLALLA).

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHPLLJE ANKANDI

Më datë 01 tetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përbarimorë do të shqyrtohen ofertat për ankandin e I-rë për shitjen e pasurisë së "MUSHIQI" shpk të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plaçh, Durrës.
Pasuria përbëhet nga dy dyqane (gjithsej rreth 245 m²) dhe tre apartamente (gjithsej rreth 245 m²) dhe mbi këto pronat nuk rëndojnë hipotekore apo nuk janë të kufizuara nga detyrime të tjera. Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë 54.000 lek/m², ndërsa çmimi fillestar për dyqanin do të jetë 81000 lek/m².

Adresa: L.2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000
E-mail: best.2010@perbarues.al, web: www.perbarues.al

NJOFTIM ANKANDI

Më datë 17.08.2018 Perbaruesja Gjyqësore Ermira Mhilli shpall ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme e lloj: Ndërtim, Kati i parë i perbarjes nga dy dhoma banjo korridor sallon dhe balkon me sipërfaqe 123 m², me nr. ndër. 1587 date 23.11.1988 e ndodhur në Z.K.8692 L.Gj. Naim Gjylbegu Rr.Sall Nivica/Shkodër.
Çmimi fillestar për Shitjen në Ankand është në vlerën \$ 707.200 leke (Pesë milion e shtatëqind e shtatë mijë e dyqind leke)
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) në ambientet e Zyrës së Perbarueses Gjyqësore Ermira Mhilli me adresë Lajç "Qemal Stafa", Rr. "Don Bosko", dhe do të perfundojë me dt. 16.09.2018 ora 16:00 (me perfundimin e orarit zyrtar)
Personat e interesuar duhet të derdhen fillimisht shumën prej 10% të vlerës si garanci në Bankën Raifaisien-Draga Shkodër.
Ofertuesit të dëshirojnë prapë Zyrës së Perbarueses Gjyqësore Ermira Mhilli, ose të kontaktojnë nepërmjet Nr.tel 0692219253 ose adresës së emailit: ermira.mhilli@hotmail.com

DEBATI

“PROPAGANDUAN KOMUNIZMIN”

PD: Të vulosen veprat me ideologji, Toçi: Kush i siglon librat e Kadaresë e Agollit?

Fatmira Nikolli

Prej disa muajsh Partia Demokratike ka nisur punën për hartimin e një kuadri ligjor që i shërben sipas saj, dekomunistizimit të shoqërisë shqiptare. Drafti i hartuar i është çuar për mendim nga pikëpamja historike dhe juridike Fondacionit gjerman “Conrad Adenauer”.

Siç ka raportuar “Gazeta Shqiptare” që në maj të këtij viti një grup pune i përbërë nga Enkelejd Alibeaj, Erald Kapri e të tjerë, kanë bërë gati një dokument prej 12 faqesh që ka në fokus ndalimin me ligj të simboleve të diktaturës dhe portretet e ish-udhëheqësve të saj. E krahas kësaj, ligji i hartuar me asistencën e CDU-së gjermane kërkon mes të tjerash edhe shfuqizimin e dekoratave, titujve që janë marrë gjatë kohës së diktaturës.

Por në dokumentin që është ende draft dhe pret propozime e rishikime, mes të tjerash vihet në dukje edhe se duhet “të ndalohen të gjitha veprat intelektuale apo artistike, të cilat kanë propagandë komuniste, një ndër to do të jenë dhe filmat e shfaqur gjatë periudhës së diktaturës hoxhiste”. Do të detyrohet Ministria e Arsimit që të rishikojë kurrikulën; dhe... Të gjitha librat apo propaganda të publikohen nëpër muzetë, për çështje kërkimore shkencore, por jo për çështje publike, siç ndodh në ditët e sotme. Në rast se dikush tenton t'i përdorë, do të dënohet me gjobë”. Prej muajit maj, kur u bënë të ditura disa detaje të draftit, shumëçka mund të ndryshojë, por së fundmi, Enkelejd Alibeaj, nënkryetar i Grupit Parlamentar të PD ka bërë me dije se në lidhje me propagandën, Partia Demokratike synon të rregullojë me ligj edhe çështjet që kanë të bëjnë me artin e realizimit socialist.

“Biem dakord që arti në një dozë të madhe në atë kohë: libra, filma apo edhe mjete të tjera të propagandës të kamufluara me elementë artistikë ishin një nga elementët kryesorë, të cilët ndikuan në deformimin e formimit artistik apo edhe politik të shoqërisë komuniste në atë kohë. Madje unë besoj që është një nga mjetet më të rrezikshme, të cilat deformuan dhe deformojnë edhe sot mënyrën se si do të duhet njerëzit të jenë të qartë për të drejtat e tyre, për lirinë”, ka thënë Alibeaj për “Vizion Plus”. Ajo që po përipiqet të bëjë Partia Demokratike është vendosja e një shënimit tek çdo film apo libër për të shpjeguar diktaturën komuniste, pa përjashtuar asnjë film apo libër përfshi edhe ata të

Projektligji i PD për dekomunistizimin hap debat, Alibeaj: Arti ndikoi në deformimin e formimit artistik, por edhe politik të shoqërisë



Agron Tufa

Agron Tufa: Veprat folje ndihmëse të diktaturës, i shërbyen lavazhit trunor e shpirtëror

një prej figurave më të rëndësishme të letërsisë sonë si Ismail

Kadare. “Mjetet që do të duhet të përdorim, siç është shoqëria e civ-

ilizuar sot, të mos e privojë individin për të marrë informacionin të cilin do, të cilin pëlqen, por duke i dhënë paralelisht në të njëjtën kohë informacionin tjetër atë real, atë të vërtetë, që në fund të fundit për çdo libër, goftë edhe të Kadaresë, kur ta lexojë të mos dalë i mpirë në arsyetimin e vet për situatën apo për gjendjen që ka qenë, por të shohë edhe faqet e tjera të librit të pashkruar të Kadaresë, ato të cilat diktatura nuk ia lejon të shkruante”, ka shtuar Alibeaj për “Vizion Plus”, që edhe pse i vetëdijshëm për debatin që hap një nismë e tillë Alibeaj beson se kjo është një zgjidhje e drejtë për shoqërinë. Ndërkohë që PD pret ekspertizën e fondacionit gjerman “Conrad Adenauer”, drafti do të mbetet në zyrat e Kuvendit nëse opozita nuk siguron konsensusin dhe votat e shumicës për të miratuar këtë iniciativë.

Për propozimin e mësipërm “Gazeta Shqiptare” ka kërkuar mendimin e Agron Tufës nga Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Fatmir Toçi, ish-deputet e botues i “Toenës”. Më poshtë mendimet e tyre.

AGRON TUFA

Mendimi im universal është që çdo vepër e çdo zhanri goftë, që në vend të detyrës artistike dhe



edukimit estetik, ka përçarur propagandë totalitare, duke idilizuar e justifikuar sistemin shtypës komunist të Partisë-shtet, s'ka asnjë lidhje me artin dhe nuk duhet të shërbejë më në kurrikulat edukative shkollore universitare dhe as të shfaqet në publik, pa e arsyetuar qëllimin e shfaqjes apo të përfshirjes në programe. Përjashtim bëjnë rastet e studimit të specializuar. Këto gjoja vepra e kanë kryer funksionin e tyre si folje ndihmëse të diktaturës, duke i shërbyer lavazhit trunor e shpirtëror: Ata kanë ndihmuar përmes heroit pozitiv zombifikimin e plotë të njeriut, formatimin e “njeriut të ri”, një mutant i verbër që njeh vetëm një të vërtetë: të vërtetën e propaganduar nga Partia komuniste dhe Enver Hoxha.

Këto vepra janë thjesht kufoma, që bartin rreziqe infektimi, përdërisa asgjë artistike e estetike nuk gjen në to, që të mund të edukojë me kanunin e artit.

Vini re, për këto “kufoma” të artit shqetësohen vetëm kreatorët e tyre, të cilët e kanë korrur lavdinë në kohën që i kanë krijuar. Tani jemi në një tjetër sistem vlerash shoqërore dhe kemi të tjera aspirata demokratike, të cilat bien ndesh me sistemin e vlerave që proklamonte realizmi socialist në ndihmë të partisë.

Personalisht nuk më vjen keq nëse nuk u shihet boja këtyre ve-

PROJEKTILIGJI I PD-SË PËR KULTESËN KOLEKTIVE DHE NDËSHKIMIN PUBLIK TË REGJIMIT TOTALITAR KOMUNIST

- Ky ligj parashikon që Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit, të marrë një rol thelbësor e të ndjekë nga afër çdo rast që lidhet me të kaluarën komuniste.

- Me ligj do të ndalohet çdo simbol komunist, siç është flamuri i Partisë Komuniste të Shqipërisë, me yll pesë cepash, drapër e cekan, portretet e diktatorit Enver Hoxha si dhe çdo portret tjetër që lidhet me të shkuarën e diktaturës.

- Ndalohet me ligj çdo imazh, parullë që lidhet me diktaturën komuniste.

- Do rishikohen emrat e rrugëve, qyteteve, shkollave, ndërmarrrjeve, emra ose pseudonime, të personave që lidhen me diktaturën.

- Të ndalohet me ligj Partia Komuniste e Shqipërisë
- Të ndalohen të gjitha ve-



prat intelektuale apo artistike, të cilat kanë propagandë komuniste, një ndër to do të jenë dhe filmat e shfaqur gjatë periudhës së diktaturës hoxhiste.

- Do të detyrohet Ministria e Arsimit që të rishikojë kurrikulën.

- Të gjitha librat apo propaganda të publikohen nëpër muzetë, për çështje kërkimore shkencore, por jo për çështje publike siç ndodh në ditët e sotme. Në rast se dikush tenton t'i përdorë, do të dënohet me gjobë.



Fatmir Toçi: Më duket një nismë për të bërë një listë censure mbi censurën



Fatmir Toçi

prave shëmtaqe e monstroze dhe ndej lehtësim, sikur lehtësohesh nga pastrimi i territorit prej plehrave toksike e radioaktive.

Kush të dëshirojë, le të komunikojë sa të pëlçasë me to, por kurrsesi nuk duhen lejuar të përfshihen në platforma, programe apo kurrikula edukimi.

FATMIR TOÇI

Më duket një nismë për të bërë një listë censure mbi censurën. Domethënë në plot kuptimin e

fjalës. Unë kam një pyetje: për të bërë shënime të librat që janë shkruajtur në kohën e diktaturës, kush do të jetë? Kush do të jetë ky që do bëjë shënime në librat e Ismail Kadarese, Dritëro Agollit, të një plejade shkrimtarësh, artistësh, kineastësh, aktorësh që në fund të fundit edhe pse në diktaturë i kanë dhënë vlera të jashtëzakonshme dhe kanë historinë e artit brenda tyre. Siç ka pasur sisteme antinjerëzore, antidemo-

kratike ku arti ka lulëzuar përmes këtij sistemi. Kush do e bëjë shenjimin? Do e bëjë Partia Demokratike apo njerëz të caktuar nga Partia Demokratike të censurejnë dhe të shkruajnë mbi librat e këtyre njerëzve me të cilët sot krenohemi edhe pse kanë ngelur pak? Ata vunë themelin e gjithë kulturës sonë identitare e kombëtare. Kjo është një marrëzi, një marrëzi politike, edhe për një arsye tjetër madhore. Sot ka kaluar një brez, nga diktatura e deri sot. 25 vjet është një brez dhe nga viti '90 deri sot ka kaluar një brez. Gjysma e popullsisë është shkolluar jashtë, sepse jeton jashtë. Ndërkohë mentaliteti edhe në Shqipëri ka ndryshuar sepse ne jemi, në mes të Evropës dhe nën ndikimin e tyre. Ndërkaq, të gjithë njerëzit janë me një celular në dorë dhe me internet në dorë, një dritare prej së cilës shohin gjithë botën, të keqen dhe të mirën. Ç'kuptim ka kjo tani, të vësh shënime nëpër librat e tyre?

Ky qenka problemi më i madh që ka Partia Demokratike sot?

E para, kjo. E dyta, që është më e rëndësishme se kjo, ka një rrugë tjetër që duhet ndjekur edhe nëse ka akoma elemente që janë në ndikimin e diktaturës, gjë që në jetën e sotme demokratike dhe normale e politike, unë nuk e shoh kaq të rrezikshme, siç po pretendojnë ata që po ndërmarin këtë nismë. Shoh probleme më të mëdha që mund të ndikojnë edhe në mbështetjen e kulturës sonë kombëtare që për hir të së vërtetës është lënë në harresë edhe në kohën që unë isha në parlament dhe nuk po bëjë aspak politike për këtë.

Po i them me gjëra konkrete që kanë të bëjnë me ligjin e artit dhe kulturës, me ligjin për librin dhe e ligjin për pakësimin e librit, dhe të veprimtarisë kulturore e artistike në Shqipëri apo të krijimtarisë së mirëfilltë që është i vetmi element që ka të bëjë me identitetin tonë kombëtar në të cilin mund të konkurrojmë, të krahasohemi, të ballafaqohemi me kulturat e shoqëritë të vendeve të tjera europiane. Ka ligje akoma edhe sot që ata që krijojnë tashmë në shumë se ata që bëjnë tregti nëpër rrugë. Nga 10 % që ishte tatimi i atyre njerëzve me pasion sot është 15%. A mundënia nga e gjithë bota politike t'i mbështesim ata që krijojnë e ata që na bëjnë krenar që jemi shqiptar, për elementet e identitetit të jenë të çliuruar?

Sot kemi 61 njësi vendore që janë bashki e 30% e tyre nuk kanë as ndërtesa të bibliotekave bashkiake. Edhe ata që i kanë ato ndërtesa kanë të paktën 20 vjet që nuk blejnë asnjë libër për të pasuruar bibliotekën e tyre. Këta njerëz që kanë probleme ekonomike e që duan të kulturohen, ku do i marrin librat? Ku do t'i gjejnë librat kur nuk ka politika të tilla kulturore?

Domethënë mua ky më duket një ligj absurd, hajde të bëjmë zhurmë për një gjë që po i hyjmë e nuk dimë fare se ku do dalë e si do dalë. Për çfarë arsye duhet bërë kjo? Ku është shqetësimi sot? Cilat probleme ka vendi sot të zhvillimit, ekonomike integritit, rritjes së mirëqenies, dhe çfarë problemesh po ngremë neve. Po bëhet një zhurmë që nuk ka për t'i shërbyer asnjëri.

SOPRANOJA

Ermonela Jaho, sërish përkrah Domingos



Tenori i njohur Placido Domingo dhe sopranoja shqiptare Ermonela Jaho kanë magjepsur publikun e Festivalit Castell de Peralada (Girona) me operën me intensitet të fuqishëm emocional, 'Thais' nga Jules Massenet, shkruan gazeta spanjolle 'El Pais'. Në shtjellimin e kësaj veprë operistike, artistët e njohur kanë magjepsur publikun me zërat e tyre të fuqishëm, nën dirigjimin e korit të Teatrit Real të Madridit. Në këtë veprë operistike murgu të ri, Athanael-it, në rolin e të cilit performon maestro Placido Domingo përpiqet të shpëtojë nga mëkatet dhe jeta e shthurur kurtizane Thais, të interpretuar nga sopranoja shqiptare me famë botërore Ermonela Jaho. Pas përpjekjeve për të kthyer Thais-in në rrugën e drejtë të Zotit e krishterimit, murgu rrëmbehet plotësisht nga ndjenjat më të forta për të, duke kapërcyer çdo vlerë, normë e besim të predikuar me këmbëngulje më parë. "Thais" është një ngjarje që të bën të reaktosh thellë mbi vlerat e shoqërisë, ku ndërthuren emocionet e forta shpërthyes, por edhe natyra medituese e karaktereve që e bëjnë këtë një veprë paksa ndryshe nga operat e Pucini-t apo Verdi-t. Prandaj Jaho e Domingo kanë krijuar me këto role një duet fantastik ku buron prej të dyve pasioni dhe energjia e madhe muzikore.

Opera "Thais" ku ata do të jenë protagonistët është një veprë me tri akte e kompozuar nga kompozitori romantik francez Jules Massenet-i dhe e shkruar nga dramaturgu Louis Gallet-i, bazuar në novelën me të njëjtin titull të Anatole France-it. Shkrimtari francez është vlerësuar gjithashtu, me çmimin Nobel në letërsi për novelën "Thais", në vitin 1921.

"Thais" u vu për herë të parë në skenë në Operën "Garnier" të Parisit, në 16 mars të vitit 1894.

Në këtë veprë operistike murgu të ri, Athanael-it, në rolin e të cilit performon maestro Placido Domingo përpiqet të shpëtojë nga mëkatet dhe jeta e shthurur kurtizane Thais, të interpretuar nga sopranoja shqiptare me famë botërore Ermonela Jaho. Pas përpjekjeve për të kthyer Thais-in në rrugën e drejtë të Zotit e krishterimit, murgu rrëmbehet plotësisht nga ndjenjat më të forta për të, duke kapërcyer çdo vlerë, normë e besim të predikuar me këmbëngulje më parë.

Ndërsa Thais dergej në shtratin e vdekjes, Athanael-i shkoj ta kërkonte për t'i thënë se asgjë në jetë nuk është aq e fuqishme dhe e vërtetë sa jeta dhe dashuria midis dy qenieve njerëzore. Vdekja e Thais e burgois Athanael-in në një dëshpërim pa kthim, pasi jeta pa Thais për të nuk kishte më kuptim. Një histori e tillë e interpretuar nga dy ikona botërore të muzikës klasike sipas mediave spanjolle "e bën të mezipriritur këtë shfaqje operistike"

Ermonela Jaho tashmë njihet për role të mëdha dhe të rëndësishme, sikurse është edhe roli i kësaj shfaqjeje, ku Jaho u prezantua në rolin e Thais. Ajo deri më sot është prezantuar në teatrot më prestigjioze të botës, duke u shpërbyer shumë herë edhe me çmime të rëndësishme. Njëkohësisht Domingo është një zë i rrallë që ka tuar zemrat e spektatorëve në të gjithë botën. "Thais" u vu për herë të parë në skenë në Operën "Garnier" të Parisit, në 16 Mars të vitit 1894.

TRAGJEDIA NE XHENOVA DETAJET

BULLGARI

Vendi më i varfër në BE, Bullgaria: Do të rindërtojme 200 ura

Pas tragjedisë në qytetin italian, Xhenova, Bullgaria do të rikonstruktojë më shumë se 200 ura. Vendi më i varfër në BE, Bullgaria do të rikonstruktojë më shumë se 200 ura. Vendi më i varfër në BE, Bullgaria do të rikonstruktojë më shumë se 200 ura. Vendi më i varfër në BE, Bullgaria do të rikonstruktojë më shumë se 200 ura.

takim qeveritar. Kryeministri bullgar, Boyko Borisov ka thënë se të gjitha urat duhet të rinovohen dhe të forcohen. "Qoftë përmes kredive, të cilat më pas duhet t'i paguajmë me taksa, apo përmes buxhetit, dua që të gjitha urat të rinovohen sa më parë", ka thënë ai në gjatë një takimi. Bullgaria, shteti më i varfër në Bashkimin Evropian, ka pranuar për dekada ndihmë financiare nga Evropa për të modernizuar infrastrukturën.




FRANCE

Fatkeqësia në Itali, reagon Franca: 30% e urave rrezikojnë shembjen

Nga 12 000 urat e menaxhuara nga shteti francez, një e treta e tyre kanë nevojë për riparime, sipas një raporti që do të kishte mbetur në harrësë, nëse nuk do të kishte rënë ura "Morandi" në Xhenova. Sipas mediave franceze, që citojnë këtë raport, në shumicën e rasteve bëhet fjalë për riparime të vogla, me qëllim paran-

dalimin e shfaqjes së problemeve strukturore, por në 7% të situatave të shqyrtuara, dëmet janë më të rënda, duke shfaqur mundësinë e rrezikut në të ardhmen për rënie, në atë pikë sa që në këto ura është ndaluar qarkullimi i mjeteve të rënda dhe në disa i krejt automjeteve. "Në situatën më të rëndë gjenden gjithsej 840 ura", sipas autoriteteve përgjegjëse.



Katastrofa në Itali, bilanci i viktimave deri tani: 38 të vdekur, dhjetëra të zhdukur

Mbetën pa shtëpi, banorët në Xhenova protestojnë: Na mbetën çelësat në dorë

Vijon tragjedia, të shtunën ceremonia mortore e viktimave

Pamela Aliaj

Kanë kaluar tri ditë nga tragjedia në Xhenova, ku shembja e urës "Morandi" mori jetën e dhjetëra njerëzve dhe shumë të tjerë u plagosën e u shpallën të humbur. Deri më tani janë konfirmuar zyrtarisht 38 të vdekur, tre prej të cilëve fëmijë. Edhe pse u përfol për 39 viktime, prefektura e Xhenovas ka bërë me dije se janë 38 viktime, ndërsa të plagosur janë 15 persona. Mediat italiane, bazuar tek informacionet e ekipeve të zjarrfikësve, raportojnë se dhjetëra persona rezultojnë të zhdukur, ndërsa ka ende shpresa që disa prej tyre mund të jenë ende gjallë. Por frika se mund të përballen me të tjera viktime nuk përjashtohet. Ndërkohë, ekipet e shpëtimit bëjnë me dije se nën rrënoja ka ende shumë makina që janë "groposur", për të cilat po punohet për t'i nxjerrë, shkruan "Corriere". Sakaq, deri më tani 664 persona janë evakuuar, ndërsa kanë braktisur kështu banesat e tyre, pasi ato paraqesin rrezik për shembje. Ndërkaq, ministri i



Brendshëm italian pohoi se të gjitha ato banesa që rrezikojnë shembjen do të rindërtohen nga e para brenda vitit. Nga ana tjetër, për shkak të kësaj tragjedie të rëndë, qeveria italiane vendosi që të shpallë ditë zie ditën e shtunë, 18 gusht. Ndërkaq, pas shpalljes së rrezikut se edhe pjesa e mbetur e urës "Morandi" në Xhenova mund të shembet, dhjetra banorë që janë detyruar që të largohen nga banesat e tyre. Ata kanë protestuar para autoriteteve

lidhur me faktin se tani mbetën të pastrehë për shkak të tragjedisë së ndodhur. Ata kërkojnë që të kthehen në shtëpitë e tyre, për të marrë sende personale apo dhe kafshë shtëpiake, që i "braktisën" sapo ndodhi ngjarja, shkruan "Republica". "Kemi dalë vetëm me pizhame", dëgjohej teksa thotë e irrituar një qytetare, ndërsa shumë të tjerë nuk i ndalin lotët. Ndërsa ka bërë përshtypje një foto e shkreptur nga Google Heart, e cila është bërë virale në in-

ternet menjëherë pas rënies së urës Morandi në Xhenova. Në foto shihet njëra këmbë e urës që duket e mbështetur në bordurën e sipërme të një prej pallateve të ndërtimeve nën të. "Por kush është ndërtime më parë, ura apo pallati?", kërkon të dijë një përdorues në internet. Një tjetër pyet: "Si mund të jetonin familjet në kushte të tilla me zhurmë dhe ajrit kaq shumë të ndotur?". Sakaq, një fotografi i ka shkakuar indignitet një foto e tillë. "Po vetëm tani e vunë re të gjithë?", komenton një banor i zonës. "Është e turpshme, vetëm zemërim dhe dhimbje", shkruan një përdorues tjetër. Në 18 gusht do të mbahen ceremonitë mortore të viktimave të tragjedisë së urës "Morandi". Sipas mediave italiane, ceremonitë do të organizohen nga shteti dhe do të nisnin në orën 11:00 të së shtunës. Ato do të mbahen në kompleksin "Fiera di Xhenova" dhe të pranishëm do të jenë përfaqësues të qeverisë dhe ndoshta presidenti Serxho Matarella. Mesa për ceremonitë do të mbahet nga arqipeshkvi i Xhenovës, kardinali Anxhelo Banjasko dhe do të zhvillohet nën kujdesin e kryetarit të bashkisë, Marko Bucì.

Shpëtoi nga vdekja, flet e mbijetuaras: Ulërija të më shpëtonin vajzën

"Zjarrfikësit biseduan me mua dhe u përpoqën të më nxjerrin nga rrënoja, por ata s'e panë vajzën time, pasi ajo ishte mbuluar e gjitha. Unë nisa të bërtas që të më linin mua dhe të merrnin vajzën time". Ky është rrëfimi dramatik i Marina Guagliata, një nga të mbijetuarat nga tragjedia në Xhenova. Gruaja tregon momentet tragjike se si ajo bashkë me vajzën e saj Kamila mbetën të bllokuara në makinë pas shembjes së urës. "Isha në gjendje t'u tregoja forcave të shpëtimit pozicionin e saktë të vajzës sime, sepse gjithmonë e mbaja prej dorë teksa ishim nën rrënoja", tha ajo, ndërsa ende shfaqet e shokuar, raporton "Republica".

Ditën e tragjedisë në Xhenova, Salvini festonte me partinë. Shpërthejnë rrjetet sociale

Mbrëmjen kur Xhenova u gjunjëzua nga një tragjedi e rëndë pas shembjes së urës "Morandi", që u mori jetën 38 personave, ministri i Brendshëm, Mateo Salvini ishte duke festuar. Disa foto ku shihet Salvini teksa bën foto i buzëqeshur dhe duke festuar, qarkulluan në rrjetet sociale duke shkakuar zemërim të madh tek qytetarët. "Republica" shkruan se Salvini ka qenë në një darkë ku merrnin pjesë 260 pjesëtarë të partisë së tij Lega. Kanë qenë vetë anëtarët e partisë ata që kanë publikuar fotot në rrjetet sociale. Dollitë, selfiet, apo edhe një tortë gjigande me foto të ministrit ku shkruhej "Fiton skuadra" ka shkakuar zemërim të madh në rrjetet sociale. Të shumë ishin ata përdorues të "Twitter"-it apo edhe rrjeteteve të tjera që pyesnin: "Pse ministri nuk ka shkuar në Xhenova? Përse nuk e anuloi darkën?".

ELIZA HOXHA, MË PROVOKUESE SE KURRË NË FOTOT E FUNDIT

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E premte 17 Gusht 2018



MODELJA

Si eshte pasi hyri n grupin OTR

ka gene

ORIOLA MARASHI ZHGËNJEN FANSAT




Tayna "çmend" me të pasmet gjigante

BULEVARDI POLITIK



- Rama bëhet gati për punë, publikon videon nga barberi. Ja biseda me adoleshentin
- Hoqi dorë nga politika, ish-presidenti 'më i varfër në botë' refuzon pensionin
- Nard Ndoka: Rezistoj në politikën shqiptare, do të bëj libër
- Familja e Jozefina Topallit shfaqet e lumtur, ja si duket Genari pas ndarjes nga Eva



Rrëfëhet e persekutuara: Jeta ime mes vuajtjesh, kërkoj vëmendjen e institucioneve

AJTANGA LUBONJA:

Të vërtetat e politikës, ja si i kam raportet me pushtetarët

"Që të më eliminosh mua duhet luftë"

Rrëfihet e persekutuar: Jeta ime mes vuajtjesh, kërkoj vëmendjen e institucioneve

AJTANGA LUBONJA:

Të vërtetat e politikës, ja si i kam raportet me pushtetarët

“Që të më eliminosh mua duhet luftë”

Egla Xhemali

Jam e lodhur"! Kjo ishte fjalja e parë që Ajtanga Lubonja na tha. Ajo është një nga personazhet e njohur në media, për të kaluarën plot dhimbje dhe të vërtetat e hidhura që rrëfen për çdo politikan. E ndërsa gjendeshim në "Qytet Studenti" në godinën familjare '13', një heshtje e frikshme kishte pushtuar korridorët. Muret të shkarravitura, të plasura tek-tuk, shkallët gjysmë të rëna. Në fund të katit të tretë, ku edhe dritën duket sikur e kishte pushtuar terri, për shumë vite jetonte zonja Ajtanga. Ambienti të lodhte, ashtu siç ajo vetë pohoi. Të jetosh mes vuajtjesh për 27 vjet në konvikte ku rëndnin ta zhvendosnin. E kaluara i ka rrënjët të thella tek ajo dhe kauza që ka mbrojtur gjithmonë është që i drejti të shpërblehet. Në një rrëfim për "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare", Lubonja ndan me ne vuajtjet, problemet shëndetësore, milletin që ka me politikanët, raportin e ngushtë dhe vlerësimin që ka për Sali Berishën, momentet e bukura në jetë dhe marrëdhëniet me të birin. E zhgënjyer nga mospërkrahja politike, ajo kërkon edhe një herë vëmendjen e institucioneve shtetërore dhe thotë se nga vendbanimi i tanishëm nuk del për asnjë arsye. Për të nuk ka politikë kombëtare, po vetëm biznese që krijohen për interesa të ngushta të pushtetarëve. Për të gjithë politikanët, zonja Ajtanga ka diçka për të thënë. Ajo thekson raportin e ngushtë me Berishën dhe pohon se ai mbetet ikonë. Momenti më i bukur në jetë ka qenë ardhja në jetë e të birit. Do kishte dashur që të kishte edhe një vajzë. Edhe pse vetëm, ajo nuk është pesimiste, madje ka qenë natyrë që ka luftuar gjithmonë. Për të djali është bota, krenaria e saj. Zonja Ajtan-



Unë jam njeri që kam jetuar mes njerëzve. Ne jemi rritur në një rrugicë që quhej "Rugica e dibranëve" e nuk kishim ndarje e imja apo e jotja. Pastaj ndodhën këto, persekucioni. Shiheshim si lebrozë, megjithatë komshinjtë aty natën vinin na sillnin për të ngrënë.



ga shkruan netëve në pritje të ditëve me diell, që nuk dihet se kur do të vijë.

Zonja Ajtanga, ju nuk keni qenë fort mirë nga gjendja shëndetësore. Si ndiheni tani?

Unë jam gjithmonë me ilaçe, të cilat më mbajnë në jetë aksidentalisht. Ilaçet për diabetin, insulinat i bëj katër herë në ditë. Të gjithë ato që jepen me rimbursim e kam thënë dhe herë tjetër në media janë të skaduara. Në takimin që pata me Presidentin e Republikës më tha që "Metforminat" nuk bëjnë, por nuk tha si të gjendej zgjidhja që të sëmurëve t'u jepet mundësia për t'u kuruar. Pensioni për të moshuarit është për relaks, qetësi e jetës. Unë kam punuar në një gjendje makabre, kam vuajtur shumë. Jam në radhën e të persekutuarve politikë. Për

dy muaj kam dhënë 88 herë gjak. I shihni dhe vetë si i kam duart nga vrimat e gjakut. Kur mora 20 lekë rrogë, thosha kujt autobusi t'i dal përpara se isha bërë 38 kg. Një vajze me këtë peshë nuk duhet t'i marrësh gjak. Kjo që po jetojmë tani është pseudo-demokraci. Siç e shikoni, unë jetoj në konvikte. Më është mohuar e drejta për të pasur një shtëpi. Do vdes në konvikte. Nuk ka asgjë do thonit, por kjo dhemb. Këtë politikanët janë bërë me 30 shtëpi. Unë e kisha të drejtën që si e persekutuar të merrja një shtëpi dhe një pension, që u bë dhe peticion kombëtar. Pensionin e kam 150 mijë lekë. Si mund të jem mirë me shëndet? Konkretisht sot në mëngjes u gdhiva me tensionin 21. Edhe fis-

hat e diabetit janë të kush-tueshme. Ku t'i gjej 25 mijë lekë çdo muaj? Të ha apo të blej ilaçet? Disa i marrë pa rimbursim. Pse quhet diabeti sëmundje e aristokracisë? Se ka dieta të veçanta. Unë nuk blej dot një frut se nuk kam mundësi. Ngaqë unë shkruaj, ma sollën energjinë 120 mijë lekë. Çfarë të bëj? E telefonova Erion Veliajn e më tha do të nxjerrim një VKM, por asgjë deri më tani. Ma pagoi tre muaj bashkia e sërisht fatura vjen 60 mijë lekë.

I keni kërkuar ndihmë ndokujt?

Unë i jam drejtuar shtetit, për mua ai ka përgjegjësi. Miqtë janë tjetër, zënë vend tjetër, janë brenda shpirtit. Shteti ka përgjegjësi, ai duhet të më ndihmoj.

Ne na kanë ndërprerë edhe lekët e të persekutuarve. Kam kërkuar takime gjithandej. Tani jam ngujuar këtu. Shihni si i kam këmbët, mushkëritë janë copë. Një jetë e mundimshme. Unë vetëm minierën nuk e kam provuar.

Në çfarë kushtesh jetoni në "Qytet Studenti"?

Km 27 vjet në "Qytet Studenti". Fillova të rrija te godina 13. Atje pastaj filluan ato bizneset. Daja i Ilir Metës e ktheu në hotel për studentët. Pastaj studentët i hoqi. Ata shkuan në shtëpi me qira, po unë nuk kisha mundësi. Atëherë laja roba në lavanderi. A mund të merrja unë shtëpi? E unë këmbëngula që nuk do lëvizja. Dhashë prononcime për gazetat dhe shtypin atëherë.

Prej andej më çuan te godina 19. Atje ishte gjendje skandaloze, pasi nuk kishte ujë. Kur kam ardhur këtu, ju betohem që as xhama nuk kishte. As çelës nuk kishte. Me një fjalë edhe po të kisha pesë lekë nuk haja bukë, po kujdesesha të shpenzoja për këtu. Edhe nga kjo godinë kanë dashur të më nxjerrin, po nga këtu vetëm të vdekur mund të më nxjerrin. Kush-tet këto janë. Fukarallëk që të mos mundësh të kënaqësh veten. E kam ëndërr të pushoj pesë ditë që të më servirin një kafe. Dora nuk më funksionon më. Nëse marr pjatën për ta larë, do më bjerë. Kjo e imja është jetë e mundimshme. Kur hap sytë në mëngjes, i hap me keqardhje dhe them "U zgjova edhe sot". Nuk kam asnjë dëshirë. Unë kam luftuar shumë. Nuk jam pesimiste.

Ju jetoni vetëm. A e ndjeni mungesën e njerëzve?

Unë jam njeri që kam jetuar mes njerëzve. Ne jemi rritur në një rrugicë që quhej "Rugica e dibranëve" e nuk kishim ndarje e imja apo e jotja. Pastaj ndodhën këto, persekucioni. Shiheshim si lebrozë, megjithatë komshinjtë aty natën vinin na sillnin për të ngrënë. Kur erdha këtu në "Qytet Studenti" isha me djalin. Ai ishte 19 vjeç atëherë. Kjo jeta kolektive ishte e bukur. Kishim shumë miqësi. Unë gatauja dhe u jepja të gjithëve. U flisja për Pavarotin. Me kalimin e kohës njerëzit u bënë më të ngurtë.

A keni raporte me kryeministrin? Cila është kërkesa që keni për të?

Ja kam dërguar privatisht me mesazh, po ashtu edhe popullit kur u bë një peticion kombëtar për t'mu dhënë pension i veçantë. I kam vajtur Blendi Klosit kur ishte ministër dhe zëvendësministër asokohe dhe më tha copë nuk e firmosim. Rama me Fatos Lubonjën janë bërë armiq tani, dikur

ORIOLA MARASHI ZHGENJEN FANSAT




Oriola Marashi është një ndër modelet më të ndjekura dhe më të përfolura për shkak të fotove provokuese. Prej kohësh ajo është pjesë e grupit të njohur OTR. Ashtu si shumë vajza të "showbiz"-it edhe modelja është akuzuar se ka kryer operacione plastike dhe se përdor fotoshop, por mesa duket kjo rezulton e vërtetë. Ndoshta jeni mësuar ta shikoni Oriolën të kuruar në çdo detaj, por nga një kontroll në të kaluarën e saj, na rezulton një ndryshim drastik pas ndërhyrjeve kirurgjikale në hundë, buzë, në vetulla dhe te mollëzat. Është vërtet zhgënjyese të krahasosh Oriolën e mëparshme me atë të ditëve të sotme.

ELIZA HOXHA, MË PROVOKUESE SE KURRË NË FOTOT E FUNDIT



Këngëtarja e njohur Eliza Hoxha ka kohë që nuk ka sjellë për fansat ndonjë projekt të ri muzikor. Ajo ka qenë mjaft e angazhuar këtë vit në fushën e arkitekturës, duke e përfaqësuar Kosovën në Bienalen e Arkitekturës në Vjenë. Mjaft e freskët dhe tejet e bukur vjen në postimet e fundit që ka bërë në rrjetin social "Instagram". Eliza shfaqet më ndryshe këtë herë e veshur në të zeza, ndonjëherë mban një pendë të kuqe në dorë. Fokusimi i linjave dhe dekoratave paksa e hapur i japin edhe një pamje më provokuese këngëtares shumë të pëlqyer nga publiku.

TAYNA "ÇMEND" ME TË PASMET GJIGANTE



Reperja nga Prizreni, Tayna ka qenë emri më i përmendur kohëve të fundit në skenën e muzikës. E kjo nuk ndodh rastësisht. E gjithë kjo zhurmë u bë për shkak të këngës së saj "Columbiana", e cila arriti një sukses mjaft të madh e pastaj edhe më këngën e dytë "Shqipe", që pati po të njëjtin sukses. Tayna është një femër e bukur dhe tërheqëse. Bukuroshja është shumë aktive në rrjetet sociale. Edhe dje ajo ka publikuar një video duke ushtruar në palestër, ku shfaq të pasmet e saj gjigante. Jo të pakta kanë qenë komentet pozitive që ka marrë Tayna për linjat e saj perfekte.

kanë qenë miq. Ai mendonte se Fatosi që ka qenë heroi i burgjeve, do realizonte ëndrrat e demokracisë së vërtetë. Fatosi nuk ka ç't'i bëjë. Ndaj më ka lënë në mëshirë të fatit.

Duket sikur keni mllafe me politikanët. Çfarë e ka përforcuar këtë ndjesi?

Kur je 70 vjeç, ke hyrë në botën e moshës së tretë, por kjo të ndihmon nganjëherë pasi thuhet që të gjithë politikanët i njoh. Le të thonë ç'të duan për Berishën. Ai ishte përfaqësues i kauzës. Cili udhëheqës në botë nuk ka bërë gabime? Ka rëndësi që të kesh shpirtin plot e paqe nga brenda. Berisha ishte i vetmi që kishte autoritet dhe nuk është marrë kurrë me pislleqe, drogë etj. Sa i përket moralit, ai do vdesë me një epitaf mbi varr "I dëshiruar për të provuar edhe një grua tjetër veç Liri Berishës". Është njeri i ndershëm, ka burrëri e mban flakën. Do thuash pse nuk të dha ky një shtëpi? Ja kam kërkuar një herë. Në fakt i nisi letrat e procedurave. Unë dy herë nuk e kërkoi një gjë. Prapë se prapë, ai ngelet ikonë. Këta të tjerët i respektoj siç bëj me të kampion socialist. Për Namik Doklen kam respekt. Socialist është, por ngelet njeri i mirë. E njoh që kur ka qenë gazetar. Atëherë kur do më hiqnin



nga puna kur punoja në Qytet Studenti ka dhënë urdhër për të mos më hequr. Kam respekt për të. Këta të tjerët që ka vënë Lulëzim Basha janë në hije. Ervin Saliqin një palaço. Është turp që bëjnë qeveri nën hije, vënë ministër të Brendshëm. Ku i gjeti paratë Saliqin? Ka bërë gjithë ato biznese. Grida Duma? Në parlament diskutoheshin hallet e popullit, po kush çan kokë. Kësaj i dolën mesazhet "Ma bëre, t'a bëra". Ajo Spiropali? E mban mend me atë bluzën zhulse, njolla-njolla? Spiropali tani me një super makinë. Këto nuk janë politi-

kanë. Këto janë ... E kam bërë një shkrim. Këto janë marioneta që i përdorin. Edhe të qeverisë kështu janë. Sa ishim ne që bënim urra për Klintonin, për Bushin etj., na dolën të gjithë se i shërbenin Soros-it. Kjo nuk është politikë. Çdo njeri duhet të mendojë për vendin e tij, për kushtet e tij. Ne jemi shumë pak, vetëm 2 milionë. Nuk kemi përkrahje, ndaj mund t'i blesh kollaj kaq pak veta. I vetëm trim në luftë nuk shkohet. (qesh)

Çfarë thirrjeje keni për klasën politike shqiptare?

Këtu nuk ka politikë ko-

mbëtare. Unë shkruaj vetë për këtë çështje shpeshherë. Nuk e shihni ç'po bëhet me Kosovën? Jo ta jap ty, po e marrë unë. Kufijtë janë vendosur në 1913. Ne i ndryshojmë sipas qejfit. Këtu ka vetëm biznese dhe ata që urdhërojnë, Sorosi. Është një shoqëri që e bazon jetën në mpirjen e gjakut të njerëzve. Mendo si e konsiderojnë njeriun. Jetë nuk ka.

Nga rrjedha e kohës, sa momente të lumtura keni pasur në jetë?

Momentit më i lumtur i jetës sime ka qenë kur jam bërë nënë. Nuk e ke idenë çfarë ndjesie. Unë atëherë

isha e imët, delikate dhe dëgjoja doktorët që donin të më fusnin në sallë operacioni. Unë kisha për borxh t'i duroja të gjitha dhimbjet. Kur më thanë është djalë ka qenë gëzim. Do të doja të kisha edhe një vajzë. Djali më bëri shumë krenare. Ata ndjekin metodën moderne sot e jetojnë më vete.

Po dashuri të humbura keni pasur?

Kush nuk ka pasur?! Atëherë e kishim të ndaluar dashurinë. Unë kam qenë natyrë si djalë, edhe pse nuk më besojnë. Merrja biçikletën dhe ikja. Rrija majë mureve. Kam pasur pasion dhe sportet. Jam marrë shumë me gjimnastikë, kam konkurruar edhe nëpër kampionate. Asnjëherë nuk më merrnin seriozisht, më merrnin si djalë.

Do thuash si u martove? Gjithmonë me atë emblemen e kalorësit mbrojtës. Ky burri që mora unë ishte nga një familje që ne kishim miqësi. Ai kishte kaluar një trazicion në dashuri. Unë punoja atëherë si gazetare te "Shqiptarja e re". Kisha mundësi të takoja njerëz të mëdhenj. Kur e rregullova këtë punë që ai të kthehej se ia kishin prerë universitetin më tha me një kusht, nëse ti bëhesh gruaja ime. Edhe unë si kalorësi i thashë do bëhem gruaja jote. Sa më

ranë hallet mua, ai tha: "Unë i përkas një familjeje të shëndosh me partishmëri, ti je armike e popullit" dhe kështu u ndamë. Ai sot jeton në Kanada s'e kam parë më që atëherë. Tani kohëve të fundit ka takuar djalin, venë e vijnë kur ai vjen në Shqipëri. E ka thirrur djalin të shkojë në Kanada, por ai nuk do. Është shumë shqiptar, më ka ngjarë mua; as unë nuk iki nga Shqipëria. Kam pasur mundësi që të ikja jashtë, po nuk dua. Dua të vdes në vendin tim.

Ju pohanu se keni një djalë. Si i keni marrëdhëniet me të?

Gjithë nënat mund të zgjasin kokën në gjyotinë dhe të vdesin për fëmijën. Më beson që ai djalë është gjithçka. Kemi qenë shumë të lidhur, shumë shokë. Çdo gjë e qanim bashkë. Mendo kur filloi punë, e di çfarë ishte dhuratë e tij? Më 31 dhjetor hyjnë atje në konvikt e mbante në duar një televizor. Më sollti televizor me ngjyra. Ai për çdo gjë më kishte mua. Nuk më pyeste kurrë ku i çoja lekët. Vjen një ditë që këtë djalë ta merr nusja. Nusja ime është vajzë e zgjuar. Është profesioniste shumë e mirë në ekonomi. Natyrisht që do të ketë pavarësinë e saj, por që të më eliminosh mua duhet luftë.



Vera është sinonimi i nxirjes për shumë prej atyre që e duan diellin, sepse ajo e bën lëkurën më kompakte dhe më të bukur, madje fsheh edhe disa defekte që na shqetësojnë.

10 këshilla për nxirjen perfekte

Përpos gjithë të mirave që na sjellin rrezet e Diellit nuk duhet të harrojmë kurrëse se ato mund të jenë edhe të rrezikshëm sidomos nëse ekspozohemi pa asnjë mbrojtje, pasi mund të kemi probleme të rënda në lëkurë.

Duke mos lënë mënjani kujdesin për lëkurën më poshtë gjeni një listë esenciale në 10 hapa për të pasur nxirjen perfekte.

- 1- Përgatite lëkurën nga ekspozimi duke bërë një pastrim për të hequr qelizat e vdekura dhe pa harruar eksfoliatin për një nxirje uniforme.
- 2- Nëse të duhet të depilohesh, çfarëdo lloj mënyrë të zgjedhësh, lëre lëkurën të qetësohet për të paktën 24 orë, për të evituar acarimet e padëshirueshme.
- 3- Aplikoni krem/vajin mbrojtës gjysmë ore përpara ekspozimit në diell për ta bërë atë sa më efektiv. Aplikojeni edhe më vonë përgjatë

ditës, nëse është e nevojshme.

4- Rrisni kohën e ekspozimit në mënyrë graduale: fillojeni duke qëndruar në diell 1 orë, për të mbërritur më pas te disa orë më shumë, si në mëngjes edhe pasdite. Bëjeni lëkurën të mësohet gradualisht me diellin e mos harroni që ka qenë për shumë muaj e mbuluar me rroba të trasha.

5- Mos u ekspozoni gjatë orëve të nxehta të ditës, madje edhe nëse je e re në moshë, sepse të shndërrohesh e kuqe nuk është mirë për më tepër që djegia nuk transformohet si me magji në nxirjen e dëshiruar, përkundrazi mund të shkaktojë një



lëkurë të shëmtuar.

- 6- Rrotullohuni dhe ndryshoni pozicionin shpesh, rreth çdo 15/20 minuta, për ta lejuar diellin të nxijë çdo pjesë të trupit. Më mirë akoma, mund të praktikosh sport ose shëtitjen në breg.
- 7- Evitoni qëndrimin për orë të tera në diell dhe më pas minuta të tera në det, ndonëse është e vërtetë që zhytja të rifreskon, por lëkura do të vazhdojë të jetë e ekspozuar në det apo pishina. Balanconi kohën duke pasur parasysh këtë këshillë.
- 8- Nëse jeni të lodhur dhe doni të merrni një sy gjumë, shkoni nën çadër, kështu do të jeni më

- të qetë për të evituar nxehtësinë apo skuqje/ nxirje vetëm nga njëra anë e trupit, duke qëndruar për një kohë të gjatë në të njëjtin pozicion.
- 9- Preferoni diellin natyral në vend të llambave nxirëse, që kanë një përqendrim të lartë të rrezeve ultraviolette, më të dëmshme për lëkurën sepse mund t'i shkaktojnë asaj plakjen e parakohshme.
- 10- Lyejeni gjithmonë shumë mirë lëkurën tuaj, duke aplikuar edhe në fund të ditës një krem të mirë hidratues ose një qetësues pas diellit. Zgjidhni produktet më të përshtatshme për ju dhe aplikojini edhe pas dushit të mbrëmjes.

Rama bëhet gati për punë, publikon videon nga barberi. Jabiseda me adoleshentin

Kryeministri Edi Rama i ka mbaruar pushimet dhe tashmë është gati t'i rikthehet punës në krye të qeverisë. Këtë gjë e tregon edhe videoja e publikuar prej tij në 'InstaStory'. Rama ndodhet tek barberi duke prerë flokët, e look-un e tij kryeministri ia ka besuar një adoleshenti nga Fieri. Kreu i qeverisë ka zhvilluar ndërkohë edhe një bisedë të shkurtër me të riun barber që i tregon se vazhdon shkollën në gjimnazin e Fierit.

Rama: Po ç'a shkolle je?
Berberi: Në Fier, "Janaq Kilica" në Fier në gjimnaz, shkoj në vit të dytë sivjet.
Rama: Këtu vjen vetëm për verë e, punon me babain?
Berberi: Po, është viti i 8 që e ka babai sivjet.
Rama: Bravo!



Hoqi dorë nga politika, ish-presidenti 'më i varfër në botë' refuzon pensionin



Ai njihej ndryshe si presidenti më i varfër në botë dhe së fundmi ka marrë një tjetër vendim. Jose Mujica ka hequr dorë edhe nga pensioni i tij. Ish-lideri i Uruguait, Jose Mujica ka hequr dorë edhe nga pensioni i tij. Ai njihej për stilin e tij modest të jetës dhe quhej ndryshe edhe si "presidenti më i varfër i botës". Mujica ka dhënë dorëheqje të martën nga posti i senatorit, të cilin e kishte mbajtur që nga 2015-ta, kur i kishte skaduar mandati pesëvjeçar si president. Ai ka thënë se nuk do ta çojë deri në fund mandatin e senatorit, deri më 2020, pasi që ishte "i lodhur". 83-vjeçari e ka zyrtarizuar dorëheqjen e tij përmes një letre dërguar kreut të Senatit, Lucia Topalonskyt, e cila është edhe nënpresidente e Uruguait dhe bashkëshorte e Mujicas tashmë 13 vjet.

BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozitet!

Familja e Jozefina Topallit shfaqet e lumtur, ja si duket Genari pas ndarjes nga Eva



Djali i ish-kryeparlamentares Jozefina Topalli ishte në një lidhje të gjatë dashurie me moderatoren e njohur sportive, Eva Murati. Disa muaj më parë ata u përfolën se i kishin dhënë fund lidhjes së tyre. Në reagimet e bëra për mediat përgjigjet ishin të zymta dhe askush nuk la të tregohet qartë se çfarë po ndodhte në jetën e tyre private, shkruan gazeta 'Express'. Më e interesuar për të mbajtur të ndërë këtë situatë ka qenë Eva. Ajo asnjëherë nuk e ka pranuar apo mohuar ndarjen. Gjatë kësaj periudhe ata nuk kanë ndarë asnjë foto së bashku duke lënë thujtë të qartë faktin se gjithçka kishte marrë fund. Studenti Genar Topalli ngatërroi gjithçka me foton e postuar në 'Instastory'. Një pikturë në Paris që tregon një çift të dashuruarish dhe krah tyre dhe qeni i familjes Topalli. Çfarë të mendohet pas kësaj...?

Nard Ndoka: Rezistoj në politikën shqiptare, do të bëj libër

Në librarinë e Drymades, kamera e "Edicionit Veror" ka hasur edhe në kreun e Partisë Demokratike dhe deputetin Nard Ndoka, i cili zbulon për herë të parë për ABC News se po përgatit një jetëshkrim. Gazetarja: "E ke menduar ndonjëherë të shkruash një biografi për jetën tënde?"



Nard Ndoka: "Për çdo njeri që ka pasur një rol, jam disa herë i zgjedhur në parlamentin e Shqipërisë, kam drejtuar Ministrinë e Shëndetësisë, janë disa gjëra që mendoj se i kam bërë mirë, pse të mos jenë të shkruara diku, qoftë edhe si dokument familjar. Kam shkruar faqet e para. Mendja është gjë e madhe, librat ta pasurojnë". Kreu i PDK, i cili mban në duar librin e shumëpërfolur "Zjarr dhe tërbim" nga Michael Wolff, shprehet se ka lexuar të gjitha librat e presidentëve amerikanë, por nëse do të shkruhej një libër për atë që ndodh pas dyerve të parlamentit shqiptar, ai thotë se politika shqiptare do t'ia kalonte edhe vetë Trumpit. "Do t'ia kalonte edhe vetë Trumpit. Politika shqiptare është e komplikuar me ambientet e veta të mbidheshme e nëndheshme, me marrëveshjet". I pyetur nga gazetarja nëse e ka kuptuar këtë lloj politike, Ndoka shprehet se: "E kam kuptuar dhe prandaj kam rezistuar goxha në politikë".

65	NIKOLL NDREC TANUSHI	205	PETRIT MARK ZEFI	344	GEZIM NDREC BOCI	483	ZOJE PREL PJOLLAJ
66	DED PRENG DEDA	206	MONDI TOM GJONI	345	RROK PREK RUDI	484	KANTO FRAN GJOKA
67	NDUE KOL MHILLAJ	207	MONDI LLESH SHTJEFNI	346	PJETER KOLE CUNGU	485	ZEF GJIN MARKU
68	KRISTO MARK KOLA	208	KLEMEND GEG SHAHINI	347	FRAN GJOK RUDI	486	JOSIF PAL BARDHI
69	FLAMUR ASHUR MELLA	209	PJETER KOL MENA	348	NDUE ZEF DODAJ	487	PELLUMI LIME MARASHI
70	NIKOLIN PAL TUSHA	210	SANDER LAZER NDOJ	349	PASHKO PREL NIKA	488	PJETER NDUE TUSHA
71	GJOVALIN MARK DEDA	211	MUHAMET ISA DUKA	350	BARDH NDREC MARKU	489	SOKOL GJON DODA
72	TOM NDOCS SHTJEFNI	212	GJIN LLESH GEGA	351	PAL PRENGE MARKAJ	490	MARASH FRAN SHKEMBI
73	LEK LLESH JAKU	213	NDREC PJETER FRROKU	352	PREK NDREK NDREU	491	PAVLIN DOD MARKU
74	PASHK FRAN METAJ	214	ARBEN GEG SHAHINI	353	GJOVALIN PRENGE PICAKU	492	GJIN PJETER DODA
75	ALEKSANDER KOL LETI	215	TOM MARK MARASHI	354	PREND NIKOLL SHERRI	493	GJERGJ GJON SKURA
76	MHILL GJON GJINAJ	216	ZEF NDUE GJINI	355	ARBEN LLESH TOMA	494	TOM PJETER NDOKA
77	MUHARREM VESEL LAMAJ	217	PETRIT FRROK FRROKU	356	NIKOLL PAL BEGU	495	GJIN PJETER NDOKA
78	BESNIK XHEMAL LAMAJ	218	PRENGE FRROK PJETRI	357	FRROK MARK PRENGA	496	MALITIN KOL MARKU
79	PASHK MARK NIKOLLI	219	ISMAIL HAXHI MARKAJ	358	BIB NDUE NIKOLLI	497	HASAN BAJRAM BRUNGA
80	GJOVALIN KOL PERLLESHI	220	VITOR PAL MALAJ	359	NDUE ZEF MARKU	498	AGOSTIN NIKOLLI NIKOLLA
81	CESK PAL UKAJ	221	NIKOLL BIB LLESHAJ	360	PREND PALE PERNDOJ	499	NIKOLL PAL PALOKA
82	VIKTOR GJELOSH COTAJ	222	MUHAMET IDRIZ DUSHKU	361	PRENG PJETER GJOKA	500	EDMOND HIL TUSHI
84	XHULIAN PETRIT NDOCI	223	ARBEN MARK NDOCI	362	GJOK PRENG GJOKA	501	LAZER LLESH SHTJEFNI
85	PREND TOM NDOCI	224	GJOKE LLESH MRRUKU	363	NDUE NIKOLL BARDHI	502	ARBEN GEG PRENDI
86	JAK PREK MARKU	225	MUHAMET ISA DUKA	364	GJIN NDUE GJINI	503	PASHKO LAZER PRENDI
87	JAK NDUE MICI	226	DODE LAZER NDOCI	365	SPIRO PRENG FRROKU	504	PAL FRROK PRECI
88	NDUE MARK PRENGA	227	VIKTOR NDUE KUÇAJ	366	GJERGJ NIN MARGJINI	505	GJIN MARK LLESHI
89	NIKOLIN PJETER PALI	228	ZEF GJON SKURA	367	PRENG FRROK LLESHI	506	DODE LAZER GEGA
90	PASHKE NDUE POJA	229	FATMIR SULEJMAN TAPA	368	KOLIN ZEF LEKA	507	NDREC FRROK NDRECA
91	PAVLIN NDUE PREKA	230	PJETER MARK NDOJA	369	MARASH SHKURBIJA	508	GJOKE PAL MARKU
92	LAZER PAL PEMAJ	231	FRAN SIMON DODAJ	370	PJETER MARK GJOKA	509	LEONAT GEGE PRENDI
93	AGRON DED NDOCI	232	VIOLETA PASHKO PRECI	371	VALENTIN NIKOLL LULAJ	510	GJIN DOD HABERI
94	PJETER VLASH PEMAJ	233	KISHA KATOLIKE "DIOEZA E LEZHES"	372	LULE DED ULNDEKRAJ	511	VITORE PAL DODA
95	ALTIN PJETER PEMAJ	234	ESAT MUSTAF DUSHKU	373	GEZIM NDUE ZEF AJ	512	GEZIM NDUE DUSHI
96	SHKELQI HIL ALIU	235	LEK GJIN TUSHA	374	PAL ZEF FATA	513	EDMOND PREND TATEJ
97	GJIN NIKOLL NDOCI	236	LANDI ZEF DODAJ	375	PJETER NIKE LICI	514	LEK DOD POJA
98	SHABAN RAMAZAN MYRTA	237	NIKOLL NDOCI SIMONAJ	376	NDOC LUIGJ KASNECI	515	ALTIN MARK NIKOLLI
99	GJERGJ FRROK PALI	238	NDUE NIKOLL MULA	377	HAXHI XHEMAL ZIRA	516	ARBEN SHTJEFENI GJOKA
100	MUSTAFA OSMAN SEFA	239	GJON PRENG MRRUKU	378	LLESH GJOK DED GJONAJ	517	FILIP PAL PALUKU
101	PREND NDUE BEKA	240	PETRIT TOM GJOKA	379	EDIN SENDER KASMI	518	MALIN NDUE MARKU
102	PRENG NDREC ZEFI	241	LUIGJ NDREC ZEFI	380	DED KOL PALOKA	519	GJERGJ NDUE MARKU
103	PRENG GJETE MARKU	242	ZEF GJET TANUSHI	381	GEZIM GJON PRENGA	520	PAL NDUE NDOJ
104	ARBEN ZEF PRENGA	243	GJOVALIN GJOK MICI	382	NDUE MARK CUPI	521	MARJAN MARK MARKU
105	ANTON NIKOLL MARKU	244	ZEF GJET TANUSHI	383	PREND TOM NDOCI	522	DOD PRENG PERDEDAJ
106	NDUE ZEF PALI	245	HIL NIK COLI	384	NIKOLL MARK MARKU	523	MARK NIK MARKU
107	GJON MARIE BAJRAKTARI	246	HIL KOL MARKU	385	MARK JAK SHTJEFNI	524	GJON HIL PEMAJ
108	PAJTIM GJET DEDA	247	FRROK NIKOLL HILA	386	MIRASH GJON BAJRAKTARI	525	SANDER GEG KOLAJ
109	GJON PRENG CUNI	248	FERDINAND LUIGJ PALAJ	387	LLESH NDUE POJA	526	DONIKA NDUE GEGA
110	SEFEDIN ALI PASHKAJ	249	HIL LLESH GEGA	388	SANDER MARK NDOCI	527	LLESH PRENG NDRECA
111	GJERGJ ZEF KEÇI	250	GJERGJ JAK JACI	389	PJETER VLASH PEMAJ	528	MARTIN NDUE PRENDI
112	LUK DED TOMA	251	LEK GJIN TUSHA	390	ALEKSANDER NIKOLL GJINAJ	529	DAVE LLESH LIMSHI
113	PAL NIKOLL LLESHI	252	ANILA KOL SMAKAJ	391	ZEF PRENG DEDA	530	SIMON FRAN MALOTAJ
114	TOM GJIN GEGA	253	KISHA KATOLIKE "DIOEZA E LEZHES"	392	ROLAND SARAFIN MARKU	531	TOM JAK LORECI
115	LEK LAZER FRROKU	254	LUIGJ GASPHER COLI	393	AGRON LLESH PERNDRECA	532	LEKE GJIN NIKOLLI
116	SANDER PRENGE LLESHI	255	PASHKO GJOK MARKU	394	LINE NDUE MARKU	533	NIKOLL GJON TARAZHI
117	NIKE PJETER BASHAJ	256	LLESH NDUE NDRECA	395	PRENDEK NIKOLL ZIU	534	ZEF PRENG PERGJOKA
118	HASAN SALLIKU	257	KASTRIOT GJIN LLESHAJ	396	NIKOLL GJON TARAZHI	535	ANTON GJON DEDA
119	IEDIN MUHARREM KADIAJ	258	TRIFON LAMI GOGA	397	MEHMET NEZIR TUGA	536	KRESHNIK PREK GJERGJI
120	AGOSTIN LAZER VESHITI	259	PREND NDUE NDRECA	398	ARDIAN LAZER NDOCI	537	PASHKO NDUE KOLA
121	GEZIM PRENG LLESHI	260	LUIGJ ZEF FRROKU	399	GJOK PJETER TOSKU	538	DRANDE ZEF LETI
122	MIRASH NDUE LEKAJ	261	FAHJO LA FERIT PJETRI	400	PAJOLA ERINDI	539	HARJEN STAF SELI
123	NIKOLL NDREC LLESHI	262	KOL NDOCI NDOJ	401	GJON MARASH KAPLLAJ	540	PRENG NDUE HILA
124	DAVIDA LAZER NIKOLLI	263	PAL FRROK ZEFI	402	ARBEN NDUE MARTINI	541	LEK GEG MARKU
125	AGUSTIN NIKOLL GJONI	264	VLASH GEG PRENDI	403	ALTIN VLASH MARTINI	542	TONIN JAK TUSHI
126	GJOVALIN MARASH GILAJ	265	PAULIN GJOVALIN PALUSHAJ	404	PRENG BARDHOK MERDHOQI	543	NIKOLL JAK ROBI
127	PRENG FRROK NDOJ	266	PAULIN GJOVALIN PALUSHAJ	405	GJERGJ PJETER NDOCI	544	VITORE KOL DELGJONA
128	MARK MREK PJETERI	267	MARK MREK PJETERI	406	MARIE TOM NDOCI	545	PAL PJETER LESHONI
129	MHILL LULASH LULA	268	GJON DEMUSH PJOLLAJ	407	NDUE MARK PRENGA	546	MARTIN DED BOBAJ
130	MONDI NIKOLL NDOJ	269	LLESH GJOK GEGA	408	GJON NIKOLL GJOKA	547	NIKOLL GJERGJ GJINAJ
131	GAZMEND PRENG NIKOLLI	270	BIB LUK VORFAJ	409	NDUE NDUE NDRECA	548	DEDE GJON GJOKA
132	PETRIT GJERGJ PEMAJ	271	PJETER NDUE PJETRI	410	SEFULLA HYSEN LIKA	549	BARDHOK NDUE NIKOLLI
133	ALEKSANDER FRROK UKAJ	272	PAL NIKOLL SIMONAJ	411	LUIGJ GANDEK CUPAJ	550	PRENG NDUE KAJOCI
134	GJERGJ NIKOLL MATRIZI	273	PAL NIKOLL GJONI	412	NIKOLL ZEF TUSHI	551	ALEKSANDER MARK NDOCAJ
135	SHOQERIA V.A.L.E RECVCYLING SH.PK	274	PERPARIM FERIZ SYLA	413	EDMIR FATMIR LIKA	552	LULJETA PASHK GJONI
136	SHOQERIA V.A.L.E RECVCYLING SH.PK	275	ZEF NIK MARASHI	414	PJETER GJOKE TOMA	553	KOL LUK MARKU
137	KOLE GJERGJ GJERGJI	276	ARBEN MARK NDOCI	415	GJERGJ RROK MARASHI	554	KOLE PRENG KOLA
138	MHILL GRANDE GJOKA	277	GRANDE GJOKA	416	PASHKO NDUE NDRECA	555	BARDHOK GEG GEGA
139	VLASH NDUE PRECI	278	ARBEN SIMON DODAJ	417	ALMARIN GJOK MIRUKAJ	556	LLESH GJET DEDA
140	FLORIN TOM CUKU	279	SHTJEFENI PJETER COLI	418	ASLLAN PETRIT KETA	557	ARDIAN GJET DEDA
141	TONIN MHILL GJONI	280	KOL PAL GJOKA	419	BIB LUK VORFAJ	558	GJERGJ NDUE SULI
142	PJETER ZEF BIBA	281	RAMAZAN HABIB KOÇI	420	PETRIT GJERGJ PEMAJ	559	LAZER PALUSH PRELA
143	MARIE FRROK NIKOLLI	282	VASIL PAL HABERI	421	GEZIM KOL DEDAJ	560	ARDIAN PJETER GOSTINI
144	PALIN NDUE PERVATAJ	283	GJON NIKOL MAKAJ	422	FRAN GJON VORFAJ	561	NIKOLL PREND PRENDI
145	FRROK PREK VATAJ	284	PASHUK FRROK GJOKA	423	VITOR NDUE KUÇAJ	562	VLADIMIR DAN HOXHA
146	PASHKO ZEF BARDHAJ	285	NARDI KOL NDOJ	424	FLAMUR FETA TOSKA	563	GJEVALIN PRENG BUNA
147	BUKURLE LUPO ALIAJ	286	PETRIT MARK NDRECA	425	ARBEN SIMON DODAJ	564	PRENG PJETER BUNA
148	GJELOSH BARDHOK PRENDI	287	MARTIN PAL PEMAJ	426	PASHKO NDUE PREKA	565	NDUE ZEF VOKRRI
149	NIKOLL NDUE JAKU	288	FATMIR PAL PEMAJ	427	GJOKE NDUE SHTJEFNI	566	NIKOLIN TOM PALAJ
150	GJOVALIN NDUE PRENGA	289	VLASH PREND NIKA	428	LUIGJ ZEF PEMAJ	567	MARJEN KOL DEDGJONAJ
151	GJON MARK MARKU	290	FRROK NDUE PJETRI	429	FATBARDH SYL BYBERI	568	ALEKSANDER NDUE GJOKA
152	EDUARD MARK PICAKU	291	NDREC SIMON DOCEJ	430	PALINE PASHK GJINI	569	EDMOND PAL NDOJ
153	NDUE NDUE LUGJA	292	JAK PJETER GJONI	431	BARDHE MARK PERKEQI	570	ALTIN PAL NDRECA
154	PJETER NDUE LLESHI	293	GJAC LAZER ZEF	432	MARIN LLESH VATI	571	KRISTIN PAL PEMAJ
155	MHILL GJERGJ NDOJ	294	FRROK LLESH NDOJ	433	TUC PRENG PRENGA	572	GEG NDUE PEMAJ
156	LEK GJERGJ NDOJ	295	PREND GEG BIBAJ	434	LLESH NDUE NDOJ	573	GJETO PJETER CUNGU
157	LEK NIKOLL BUSHKOLAJ	296	PALINE MARK NDOJ	435	ANTON MARK NDRECA	574	PAULIN NOSH SHABI
158	BIBE MARK NDOCA	297	DED ZEF MARKU	436	SOKOL GJERGJ NDRECA	575	DRIFAN LLESH LLESHAJ
159	LEK TOM MARKU	298	ZEF NIKOLLA MARKU	437	GEZIM PAL MARKU	576	GJERGJ PAL PEMAJ
160	MARK NIKOLL GJERGJI	299	VALENTIN GJOVALIN MARKU	438	NDUE NIKOLL GJINI	577	ARBEN GJOK SHTJEFNI
161	ARDIANA MARK MARKU	300	ALEKS NIKOLL NDOJ	439	GJERGJ NDUE LEKAJ	578	NIKOLIN PRENG DODA
162	SIMON NDUE NDREKA	301	DRITAN NIKOLL DOCEJ	440	VITAL HIL NIKOLLA	579	AGUSTIN MARK NOKU
163	PAL ZEF SHKURTI	302	KOLEC MARK HILA	441	KRESHNIK GJON SIMONAJ	580	MARASH LLESH KOLA
164	ZEF NDUE NDOCI	303	ZEF NDUE NDOCI	442	ARBEN MATTI MARKU	581	KOL PJETER BEKA
165	PASHKO PAL NDRECA	304	ANTON PREND NIKOLLI	443	ANTON PREND NIKOLLI	582	LEZE SHTJEFENI NDRECA
166	MIRASH LLESH LLESHI	305	GJERGJ NDUE MICI	444	NDOC DED LETI	583	TONIN KOL MUÇAJ
167	KOL LEK PIROLI	306	LLESH MARK MARKU	445	ARANIT PAL MARKU	584	LANDI PJETER GJONI
168	ALEKSANDER PRENG TUSHAJ	307	GLEDIS PAULIN CAMAJ	446	PETRIT LAZER TOMA	585	ALEKSANDER PJETER LESAJ
169	DEDE NDUE NDOJ	308	BURKURIE GJON MARASHI	447	PETRIT LAZER MATLIA	586	VALBONA JAK BUSHI
170	ZEF LUK MARKU	309	ARTIJOL ZEF CUPI	448	VLADIMIR NIKOLL SHAHINI	587	LLESH PJETER LESI
171	MARK CUB MANDREK	310	PJETER GJON KOLA	449	TOM NDUE LEKAJ	588	JETMIR ISLAM ZEGIRI
172	ALEKS LUIGJ PRODANI	311	KUJTIM GJON GJOKA	450	AGIM NDUE BUSHPEPA	589	PJETER GJIN SIMONAJ
173	NDUE NIKOLL PRELA	312	LUIGJ GJETO PALAJ	451	PJETER JAK HILA	590	VASIL PREK NIKA
174	GJOK ZEF GJOKA	313	DEJVLUGJ SHYTI	452	LUIGJ NDREC KOLECI	591	SHPETIM PRENGE NDRECA
175	ALI HAZIS GJATA	314	PETRIT MARK ZEFI	453	ARBEN ZEF TUSHAJ	592	BLERIM GJERGJ GJINI
176	GEZIM KOL DEDAJ	315	MONDI TOM GJONI	454	ILIR REXHEP KOLIQI	593	GJON JAK SIMONAJ
177	SOKOL MARK MALUTA	316	MONDI LLESH SHTJEFNI	455	ENKILETA EJLL DALJA	594	ARTAN PALOKE NDREKA
178	ROLAND MARK PJETRI	317	KLEMEND GEG SHAHINI	456	ALEKSANDER MARK KOLA	595	NDOC VLASH GJINAJ
179	LEK ZEF MARKU	318	PJETER KOL MENGA	457	VLASH PRENG MATLIA	596	PJETER GJON PRENDI
180	PAVLIN FRAN PREKA	319	SANDER LAZER NDOJ	458	ALEKSANDER PREND DODA	597	PREND FRAN BRRAKAJ
181	LEK GJERGJ MARKU	320	MUHAMET ISA DUKA	459	VALERIE PJETER LORECI	598	PRENDE PAL NELI
182	ELENI SPIRO PAPA	321	GJIN LLESH GEGA	460	TOM NDUE LEKAJ	599	GJIN MARK DEDA
183	GJERGJ NDUE KEÇI	322	NDREC PJETER FRROKU	461	PJETER NIKOLL GJONI	600	LUAN PJETER KULI
184	PJETER PRENG PEPA	323	ARBEN GEG SHAHINI	462	GANXHE ZEF TUSHAJ	601	MARTIN ZEF TANUSHI
185	GJOK DED KAÇORRI	324	TOM MARK MARASHI	463	SHTJEFENI MARK PRENDI	602	ENVER ZYLAL ANO
186	MARK NDUE MARKU	325	MIRANIM PASHK TOSKU	464	PREK GJERGJ GJOKHILAJ	603	SHKELQI ZEF BARDH KOLECI
187	FRAN MARASH MARTINAJ	326	VASIL MARK PERLIKA	465	PREND NDUE PJETRI	604	LEK PJETER LULI
188	VILSON FRROK BILAÇI	327	JETMIR LLESH NOKA	466	HIL LLESH SHTJEFNI	605	ENGJELL GJERGJ GJONI
189	FRAN GJELOSH POPAJ	328	PETRIT PASHK HILA	467	PREND PAL PALI	606	MHILL KOL TRASHAJ
190	FRROK NDUE LIKA	329	MARR PRENG CILI	468	VLASH JAK MARKU	607	KOLEC NDUE SULI
191	FATMIR DRISG REXHA	330	FRAN PREK MARKAJ	469	VJENTIN PREND TATEJ	608	SHKURT LLESH KOLA
192	GJERGJ NDUE VULAJ	331	GJERGJ NDUE MARSHTJEF AJ	470	ZEF VIKTOR KOVAÇAJ	609	GJIN MARK DEDA
193	GZIM LUSH MARKU	332	FRAN PRENG PEPA	471	GJOK GJERGJ KOVAÇAJ	610	ARBEN GJON DODA
194	MUSA RIZA KARAMUÇA	333	PAL PJETER LLESHAJ	472	FRAN NDUE BUSHPEPA	611	LUIGJ GAC NDOKA
195	MARR NIKOLLE PEMAJ	334	PAVLIN GJON GJONI	473	GJERGJ LLESH PRENGA	612	GJOKE TOME MARKU
196	FRROK NDUE FRROKU	335	PAL DED PRENGA	474	RUTE NDUE PERFATHI	613	GJIN MARK LLESHI
197	PJETER MARK BIBA	336	PAL MARK PERIAKU	475	DILE NIKOLL BROZI	614	DODE LAZER GEGA
198	GJERGJ ZEF GJEÇI	337	EDMOND MARK DODA	476	KASTRIOT ALI SULEJMANI	615	NDREC FRROK NDRECA
199	LLESH NDOCI NDOJ	338	ALEKSANDER BARDHOK GJONAJ	477	NOSH FRAN GJOKA	616	LEONAT GEGE PRENDI
200	ZEF FRROK ZEPI	339	MARR NDUE TOKRRI	478	LEK VUKSAN MALOTAJ	617	GJIN DOD HABERI
201	DASHAMIR PASHKO GUSHKU	340	NDREC NDUE NDOCI	479	ZEF PREL PJOLLAJ	618	VITORE NDUE DODA
202	FERDINAND MREK BRUKU	341	GEZIM MUSTAFI KEKA	480	LEK GJIN MARKU	619	GJON DOD HABERI
203	PJETER PAL SHAHINI	342	NDRE BARDHOK BUSHPEPA	481	ARBEN GJIN BIBAJ		
204	DEJVLUGJ SHYTI	343	NIKOLIN HIL HILA	482	ILIRIAN NDUE VOKRRI		

Dje në "Zëri i Amerikës"

Çështja kryesore është sovraniteti i Kosovës, jo shkëmbimi i territoreve

Nga David Kanin

... e cunjon diskutimin për Kosovën dhe Serbinë. David Kanin, profesor për Studime Evropiane në Universitetin "Johns Hopkins" në Uashington thotë se historia e Evropës është një histori e ndryshimit të kufijve. Por në këndvështrimin e tij, debati i rihapur për këtë temë është dytësor dhe çështja më e rëndësishme është ajo e sovranitetit të Kosovës, që do të mbetet e hapur për sa kohë nuk njihet nga Serbia dhe nga pesë anëtarët e BE-së, që nuk e kanë pranuar pavarësinë e saj. Zoti Zoti Ameriks e intervistoi gazetarja e "Zërit të Amerikës", Keida Kostreçi

Zëri i Amerikës: Zoti Kanin, ju jeni mes ekspertëve që e njohin rajonin që e kanë ndjekur me vëmendje diskutimin e rihapur për shkëmbim territori, ndryshim kufijsh, apo ndarje mes Kosovës dhe Serbisë. Por mendoj se ju jeni ndoshta i vetmi që keni shprehur shqetësim se kjo përbën një kërcënim për statusin e Kosovës. Pse?

David Kanin: Unë nuk mendoj se ky diskutim kërcënon statusin e Kosovës. Statusi i Kosovës ishte i kërcënuar që në fillim. Konteksti është sovraniteti i cunuar i Kosovës. Nuk është një shtet i njohur universalisht. Nuk ka rëndësi sesa vende e njohin, pesë vende të Bashkimit Evropian nuk e njohin dhe sigurisht edhe Serbia, Rusia dhe Kina. Çështja është statusi i kontestuar i Kosovës. Diskutimi i tanishëm për ndarjen sado i zhuurshëm merret me çështjen dytësore se cili (vend) merr cilin territor. Pyetja për sovranitetin e Kosovës është çështja kryesore dhe do të mbetet e hapur për sa kohë nuk njihet nga Serbia dhe nga pesë anëtarët e BE-së që nuk e njohin dhe unë nuk shoh shenja se kjo do të ndryshojë. I gjithë ky diskutim nuk ka lidhje me këtë.

Zëri i Amerikës: Shkëmbimi i territoreve mund të ndodhë midis dy shteteve sovraane. A nënkupton kjo që Serbia duhet ta njohë Kosovën më parë? Si mund të hyjë Serbia në diskutim me një territor që sipas saj nuk është shtet?

David Kanin: Jo, nuk është e thënë. Pjesë e diskutimeve ka qenë mundësia që Kosova të marrë një vend në Kombet e Bashkuara, domethënë që të mos njihet zyrtarisht (nga Serbia). Kjo do të bënte të mundur që Serbia të shmangte njohjen e *de jure* të Kosovës. Shumë akademikë dhe diplomatë perëndimorë do të ishin të kënaqur me anëtarësimin në OKB, duke menduar se vendi në OKB do të thoshte njohje e pavarësisë. Jo, nuk do të thotë këtë. Kosova do të ishte në OKB dhe një shkëmbim territori mund të ndodhte - dhe e përsëris që kjo është teorie dhe nuk besoj se do të ndodhë - por Kosova do të kishte diçka më pak sesa status të plotë. Tani vani kishte një vend në OKB dhe në Këshillin e Sigurimit për dekada, derisa balanca e pushtetit ndryshoi dhe tani Kina është në OKB dhe Taini vani. Jo. Kosova nuk është Taini vani, është një kontekst tjetër, por ngjashmëria mes dy situatave do të ishte se Kosova nuk do të kishte sovranitet, do të kishte vetëm një vend në OKB, që është shumë më pak. Kjo ka qenë pjesë e diskutimeve. Sipas pikëpamjes sime, nëse Kosova pranon që në fillim më pak sesa sovranitet të plotë, si pjesë e marrëveshjes fillestare, atëherë e ka humbur lojën.

Zëri i Amerikës: Çfarë mendoni për idenë në vetvete?

David Kanin: Ndarjen?



Zëri i Amerikës: Njerëzit po e quajnë shkëmbim territori, ndryshim kufiri. Nuk e di nëse mund të qihet ndarje nëse palët bien dakord...

David Kanin: Çdo shkëmbim territori dhe lëvizje popullore - dhe të dyja këto do të ndodhin me këtë ide - sido që t'ia vësh emrin, do të ishte sakrilegjë në sytë e institucioneve perëndimore, diplomatëve OJQ-ve, akademikëve dhe intelektualëve publikë, që kanë një farë besnikërie patologjike ndaj demokracive laike, shumetnike, të integruara, si rruga e vetme për të ecur përpara, rruga evropiane. Angela Merkel tha përsëri se kufijtë në Ballkan nuk do të ndryshojnë. Historia evropiane është një histori e ndryshimit të kufijve dhe lëvizjeve popullore. Kjo nuk ka ndalur. Çdo ndryshim i Jugosllavisë që kur Jugosllavia u shpërbë ka qenë për ndryshim kufijsh lëvizje njerëzish, disa të mbështetur nga perëndimi dhe disa të kundërshtura.

Ajo që po them është se elitat perëndimore që pretendojnë se dominojnë rajonin, vazhdojnë t'u thonë njerëzve në rajon se nuk ka alternativa përveç demokracive shumetnike, laike të integruara. Çdo zhvendosje territori që do të sillte lëvizje njerëzish dhe njohje e çdo gjëje mbi baza etnike është sakrilegjë, sulmohet si ide, gjithkush thotë që është e tmerrshme, se nuk mund të ndodhë. Pra është diçka që ka të bëjë me politikën e perëndimit dhe ndjesisë së tij të privilegjit në rajon, pasigurive të veta për problemet e veta dhe modelin e veta dhe mendoj se patologjia për këtë nocion, e cunjon diskutimin, do të thotë që nuk lejohesh t'i shqyrtosh këto lloj idesh. Dhe është kjo mungesë e shqyrtimit të mundësisë për ndryshim që do të ishin të ngjashme me ndryshimet që kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin në Evropë, lënia e të gjitha atyre jashtë, që e ndryshon drejtimin e diskutimit dhe bën që të mos jetë shumë i vërtetë sipas mendimit tim dhe sjell si rezultat mungesë zgjidhjeje, e lë pezull statusin aktual dhe mendoj se do të vijë dita kur të ketë një raund të ri luftimesh, që të në Maqedoni, Bosnje, Kosovë, do të ketë raunde të reja vëzhgimesh, pjesërisht sepse shqyrtimi i mundësive të tjera përveç atyre që lejohen nga institucionet perëndimore nuk lejohet.

Zëri i Amerikës: Pra ju mendoni se kundërshtimi nga Perëndimi ia ndryshon drejtimin diskutimit?

David Kanin: Mendoj që ia ndryshon drejtimin dhe e frenon dis-

kutimin, e mban rajonin në pozita varësie. "Nuk janë gati për këtë apo atë". Kjo e gjitha presupozon se të huajt i lejojnë vetes të drejtën që t'u thonë njerëzve në rajon se ç'të bëjnë. E bllokoi diskutimin.

Zëri i Amerikës: Ju sa folët për pozicionin e Kancelares Merkel, pozicionin e Bashkimit Evropian, por pozicioni i Shteteve të Bashkuara ka qenë më pak i qartë. Më parë ishte thënë se nuk do të kishte ndryshim kufijsh dhe shkëmbim territoresh ndërsa tani thuhet se palët duhet të jenë elastike dhe zgjidhja duhet të vijë prej tyre. Por nuk ka qëndrim të prerë por ose kundër. A është kjo një çarje mes Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara?

David Kanin: Së pari desha të them, meqë kam punuar për qeverinë se mendimet që po shpreh janë të miat, jo të qeverisë. Jam i kënaqur që shoh një mungesë qartësie në pozicionin e Shteteve të Bashkuara, sepse ka hapur shumë gjëra për diskutim. Mendoj se saktësia e rreme e kënvështimit tradicional perëndimor dhe i kënvështimit që ende ka Evropa, i ndrysh shumë gjërat. Ideja e shkëmbimit të territoreve, lëvizjes së populloreve, ka qenë që në fillim mbi tryetë. Privatisht, njerëzit flasin për këtë në rajon gjithë kohës, ky diskutim nuk ka ndalur kurrë. Pyetja për qëndrimin e Amerikës, i ka hequr kapakun këtyre diskutimit dhe tani po bëhet hapur dhe kjo është diçka e mirë. Nuk do të thotë se do të sjellë këmbim territoresh ose ndarje, ose çfarëdo që do ta quash. Unë nuk besoj se do të ketë zgjidhje, diplomata do të ndonjë lloj tjetër, për një kohë të gjatë në rajon. Mendoj se kjo gjendje do të vazhdojë për një kohë të gjatë, derisa disa aspekte të kontekstit të lëvizin, përsa u takon fuqitë të jashtme dhe vendave. Por mendoj se mungesa e qartësisë në pozicionin amerikan nuk është gjë e keqe, duke pasur parasysh problemet në rajon dhe dëmin që është bërë nga kufizimi që perëndimi ka imponuar për një kohë kaq të gjatë. Është diçka konstruktive.

Zëri i Amerikës: Kur thoni mungesë qartësie, a keni parasysh mungesë e shprehjes së një qëndrimi publik i mundësive të tjera përveç atyre që lejohen nga institucionet perëndimore nuk lejohet.

David Kanin: Nuk jam i sigurt nëse ka një politikë koherente amerikane (për këtë çështje). Unë nuk shoh

që të ketë. Kjo nuk me shqetëson edhe aq shumë. Gjithmonë flasim se çfarë mendon perëndimi, cila është politika perëndimore, nëse popujt e Ballkanit Perëndimor do të hyjnë në Bashkimin Evropian ose jo, nëse amerikanët kanë një politikë apo jo. Unë mendoj se sa më shumë vendast i marrin çështjet në dyert e tyre, aq më mirë është, çfarëdo që të ndodhë. Unë mendoj se i vetmi shans për një zgjidhje afatgjatë është nëse për të bihet dakord nga vendet vetë dhe kjo do të kishte problemet e veta. Jo vetëm që nuk është e lehtë dhe ka shumë çështje që pengojnë një zgjidhje të shpejtë. Por mendoj se përsa kohë të ekzistojë në rajon statusi i imponuar nga perëndimi, i imponuar nga jashtë, presioni do të vazhdojë të shtohet. Do të vijë një ditë kur luftërat e viteve 1990, do të mbeten mjaftueshëm larg në të shkuarën, sa që dikush do të arrijë në përfundimin se nuk janë më të shqetësuar për dëmin e shkaktuar, njerëzit do të harrojnë për dëmin, një brez i ri do të vijë dhe do të ketë luftime prapë, unë mendoj se ka gjasë që kjo të ndodhë. Lajmi i mirë për ata takon mungesës së konfliktit, është se ka njerëz mjaftueshëm që e mbajnë mend tmerrin dhe nuk duan që ta përjetojnë prapë. Por kjo nuk do të zgjasë ndërsa vijmë brezat e rinj. Do të vijë një kohë kur status-quoja e tanishme që është tentative dhe asgjë nuk është zgjidhur në Jug të lumit Iber, do të vijë koha kur të do të ketë konflikt tjetër nëse nuk fillon të zgjerohet diskutimi, të marrë drejtim tjetër dhe nëse vendim-marrësit lokale nuk fillojnë të marrin autoritetin dhe përgjegjësinë për atë që ndodh në rajonin e tyre dhe të ndëjnë përgjegjësinë e llogaridhënies para aktorëve të tjerë lokalë që kanë interesa, jo vetëm ndaj amerikanëve, evropianëve ose apo edhe rusëve apo të tjerëve.

Zëri i Amerikës: Por si mund të ndodhë kjo kur këto vende aspirojnë të futen në klubin ku janë këto vende të Perëndimitit, të Bashkimit Evropian?

David Kanin: Mendoj se aspirata për BE-në, është pjesë e patologjisë. Ata nuk do të futen aty të pakten për të ardhmen e afërt. Data që ekziston sot është 2025 por evropianët vazhdojnë ta shtyjnë. Nuk ka shenja që evropianët janë pranë pranimi të ndonjërit prej këtyre vendeve. Shqyrtet e vazhdueshme e mbajnë situatën siç është, e ngrijnë. Por status-quoja nuk do të vazhdojë përgjithmonë, ashtu si edhe kufizimet e tjera të sigurisë të imponuara nga perëndimi që nga Kongresi i Berlinit, kanë mundur të zgjatën për një periudhë kohe dhe pastaj kur gjendja e sigurisë ndryshon, kur kushtet e jashtme të sigurisë ndryshojnë, kur konteksti ndryshon atëherë gjërat rrezohen në rajon. Dhe me situatën e tanishme, nëse asgjë nuk ndryshon kjo do të çojë në konflikt të mëtejshëm.

Zëri i Amerikës: Pra ju po thoni që nuk është ide e keqe por nuk është realiste?

David Kanin: Nuk është ide e keqe, është një bazë konstruktive për diskutim. Nuk ka asgjë mbi tryetë, mbi tryetë e askujt, nuk ka asgjë në Uashington, e sigurt që nuk ka gjë në Bruksel, asgjë në Moskë, që do ta zgjidhte këtë çështje, asnjë ide, asnjë propozim. Asnjë nga palët e jashtme nuk do ta zgjidhë këtë. Ajo që mund të bëjë është që ta ngrijnë për një kohë dhe këtë kanë bërë. Problemi është se një ditë kur kjo ngrijnë të thuhet, kur kjo situatë të kriset, per-

sonat që do të jenë viktimat do të jenë njerëzit e rajonit sepse do ta gjejnë vetën në një situatë kur gjërat përsëri do të jenë të mundura për t'u marrë.

Zëri i Amerikës: Çfarë të ngrijnë?

David Kanin: Ata përpigjen të ngrijnë kufijtë dhe kontrollojnë diskutimin për zgjidhjet e mundshme. Asgjë nuk është e pranueshme në Bruksel. Bashkimi Evropian ka nevojë të përdorë Ballkanin për të marrë meritën për çdo "zgjidhje" dhe e them në thonjëza, sepse nuk ka një zgjidhje, por për çdo "zgjidhje" që mund të japin ata, sepse evropianët janë të shqetësuar sepse tani janë të vegjël, nuk kanë atë ndikim që kanë pasur. Dhe këtu bëhet fjalë vetëm për përpjekjen e Evropës që t'i provojë vetvetes dhe të tjerëve, se janë ende të rëndësishëm në botë. Ballkani është thjesht një instrument në këtë drejtim, asgjë më shumë.

Zëri i Amerikës: Nëse kjo ide hidhet në tryezë dhe BE-ja dhe Uashingtoni bien dakord, a e vë kjo Kosovën në një pozicion më të dobët sesa Serbinë meqenëse është ajo të cilën Serbia dhe vende të tjera nuk e kanë njohur?

David Kanin: Kosova është në një pozitë më të dobët se Serbia sepse është një vend që nuk është i njohur nga të gjithë. Kjo nuk ndryshon nëse Serbia nuk e ndryshon. Serbia ka avantazhin që është një vend universalisht i njohur që ka të drejtën të japë ose jo njohjen e Kosovës. Kosova nuk e ka atë marrëdhënie me Serbinë. Mënyra se si u bë pavarësia e Kosovës në vitin 2008, dhe ne e bëmë këtë, në kemi faj, e ka bllokuar sovranitetin e saj dhe e ka vendosur Kosovën në një pozitë të pafavorshme. Ky diskutim nuk e ndryshon një gjë të tillë.

Zëri i Amerikës: Si mendoni që kjo iniciativë e prek rajonin më gjerë, së pari Maqedoninë meqë referendum po afrohet por edhe rajonin?

David Kanin: Lidhje me Maqedoninë është e qartë. Dy çështjet nuk janë identike por nuk janë as paralele. Evropianët kanë nevojë për disa lajme të mira, u duhet që diçka të shkojë mbarë në Kosovë, ose Maqedoni. Këto dy çështje nuk do të përcaktojnë njëra-tjetër, por nëse gjendja nuk shkon mirë në Maqedoni, kjo do të ushtronte më shumë presion mbi serbët dhe kosovarët nga evropianët që të gjejnë diçka, që të mund ta quajnë normalizim, që mua më duket një term shumë i keq. Nëse çështja e Maqedonisë është e suksesshme, atëherë do të ketë një lloj tjetër trysnie ndaj Kosovës që të ruajtur vëmendjen e njerëzve. Unë jam i shqetësuar se problemi i Maqedonisë do të dështojë në Greqi. Mendoj se qeveria e Maqedonisë do të jetë në gjendje që të ketë sukses me referendumin dhe nga ana e saj ta nënshkruajë marrëveshjen, por nuk jam shumë i sigurt për Greqinë. Opozita greke mund ta hedhë poshtë. Dy proceset do të ndikojnë tek njëri tjetri për shkak të nevojës së BE-së për sukses, për shkak të paqartësisë së qëndrimit amerikan, sepse i jep mundësi Rusisë të manovrojë në dy pjesët e rajonit ka rrafi hapërisë të veprojnë në dy pjesët e rajonit, si edhe në Bosnje, për gjithçka është diçka e papërcaktuar dhe për sa kohë që ka diskutime të vazhdueshme, kjo gjendje do të vazhdojë. Parashikimi im është që në fund të fundit nuk do të kemi shumë ndryshim për Kosovën, që ky diskutim do të shkojë deri në një farë pike dhe pastaj do të fillojë të zbehet. Mendoj

Opinioni **i** Ditës

Kujdes me sherret... vrasësit i kemi rrotull!

Nga Sulejman Mato

... me ne, dëgjojnë, zihen, kundërshtojnë... Më pas mund të marrin edhe pistoletën apo kallashnikovën. Në pamje të parë duken persona të zakonshëm, ashtu si ne, por, pa provo t'i prekësh? U nxeht truri... Nuk ngajné më me ne. Nuk ngajné më me racën tonë njerëzore. U humbet arsyeja. U humbet logjika dhe ndjeshmëria njerëzore, cilësi që e kanë edhe kafshët. Bëhen agresive. Pritet vetëm një çast për t'u bërë hataja. E tillë që edhe ngarja e fundit. I tillë ishte 24-vjeçari nga një fshat i Vlorës, Ritvan Zykaj, i cili vret tetë persona për një ngjarje banale. Detyra me parë, ju kujtohet, djaloshi nga Palasa e Vlorës, i qetë dhe i heshur, por hajdut pulash si Ritvani, vrau barbarisht një femijë nëmbëdhjetë vjeç, që kishte ardhur të gjuhërit nga Greqia. Ju kujtohet edhe ai tjetri nga Slatinja, dy vjet me parë, i cili bëri hatanë në familje? ...Në Levant të Fierit një kriminel tjetër vrau bashkëshorten. Burri xheloz hodhi nga kati i tretë të shoqen, për një sherr banal. Xhuvani vret sërish për një sherr banal katër personat në mes të Tiranës. Një tjetër vret me thikë të shoqen, për një sherr banal. Nurja, ai plaku tetëdhjetë e dyvjeçar i pret kokën një vajze tetëmbëdhjetëvjeçare. Lucaj vret vëllanë... Luan Mara vret dy vetë. Po ngarja makabre tek "Xhamllëku", edhe pse e paralamjësuar, ish-i shoqi i gjyqtars, sa del nga burgu vret ish-bashkëshorten, gjykatësin në Shkodër... Në të gjitha këto raste, vrasësit janë dënuar me burg të përjetshëm. Vetëm ngarja e Libofshës, 1992, ka mbetur në histori. Dy vëllezërit vrasin pesë vetë. Mirëpo të dy autorët dënohen me varje në litar. Vitet e para kishte ligje. Krimi dënohet me vdekje. Sot, siç na dëgjojnë veshët, vrasësi Ritvan Zykaj vret 8 persona, pleq, gra e femijë, të gjithë kushërinj të vet dhe gjykatat kërkon të dijë shkaqet... Për dënim me vdekje as që bëhet fjalë... Si mund të bëhet fjalë për dënim me vdekje të një vrasësi terrorist, kur pretendojmë të hyjmë në Europë? Ironi e kohës...

Vrasje tek ne bëhen çdo ditë, çdo javë e çdo muaj. Vrasjet dhe vdekjet janë bërë pjesë e jetës sonë. Me vrasje të tilla mbushen çdo ditë kronikat televizive. Zgjohehi çdo



mëngjes me gjak të ngrirë... Vrasje në Tropojë, vrasje në Shkodër, vrasje në Fier, vrasje në Vlorë... Shumica e vrasjeve linden nga varfëria. Të tjerat janë produkte të grindjeve mbi pronën, pasojë e ligjit famëkeq 7501. Të tjera vrasje ndodhin për larje hesapsh, ose për punë xhelozie. Cilido qoftë shkaku, ajo që duhet të na shqetësojë të gjithëve është kujdesi që duhet të kemi për të kuptuar se midis nesh ka persona gjaknxehtë e të predispozuar për ta zgjidhur problemin me armë. Armët janë sheshit. Kështu që edhe mundësitë për vetëgjyqje si janë më të mëdha. Vrasësit i kemi midis nesh. I kemi në familjet tona dhe në shoqërinë tonë. Në mungesë të gjykatave persona të tillë vendosin lehtë për ta zgjidhur problemin me vetëgjyqje. Qëllimi i këtij shkrimi është thënë nga populli: "I urti duhet t'i hapë rrugë budallait".

Duhet të jemi në çdo çast të kujdesshëm për të kuptuar se kush është budallai, kush është vrasësi, kujt i merr koka erë, kujt duhet t'i ruhemi dhe si duhet të sillemi me këta persona problematikë, para se të ndodhë hataja. Hatatë në Shqipëri kanë vite që ndodhin. Në një vit vriten mesatarisht 400-500 persona. Për problemet e pronave, sipas të dhënave statistikore, gjer tani janë vrarë rreth dhjetë mijë persona. Shifer e madhe për një vend të vogël. Shteti kujdeset për statistika, por nuk kujtohet të mbledhë armët, sidomos në ato zona kur armët ndodhen sheshit dhe në dorën e "budallait".

Jeta dikur paguhej me jetë. Kështu është dhe me Kanun... Mirëpo, tani me vrasjet e tilla makabre na duhet të sillemi si evropianë... Evropa na ka vënë kushte: "Doni të hyni në Europë? Mos e vrisni Ritvan Zykajn, i cili vrau tetë vetë, dënojemi me burgim të përjet-

shëm". Që do të thotë vrasësin ta ushqejë shteti përjetësisht e në rastin më të keq, kur vrasësi paguan, të dalë nga burgu e të nisë drejt tyre, Europë dhe Amerikë. Ligji me vdekje mund të hiqet në vendet e qytetëruara, por jo në një vend si Shqipëria, e cila e ka edhe në Kanunin e vet të moçëm dhe ku armët janë sheshit.

Pas vrasjes së fundit të tetë personave nga kriminelit Ritvan Zykaj, i gjithë opinioni shqiptar kërkon të aplikohet sërish ligji me vdekje. Viktimat ishin të shumta, ndonëse shkaku, grindja banale për hijç mosgje ishte e njëjtë si për të gjitha grindjet e tjera, Ritvan Zykaj ishte në embrion një vrasësi pazhvilluar. Me katër klasë shkollë. Një shoqe e tij e klasës shkruan në "Facebook" se ai kishte mbaruar me vështirësi vetëm klasën e tretë fillore. Madje, nuk dinte as të fliste mirë. "Unë - thotë shoqja e tij e shkollës fillore - e kisha kuptuar prej kohësh qysh kur e kisha në klasë dhe e kisha marrë në patronazh, se ai ishte një lloj debili i një natyre të veçantë, madje edhe agresiv". Ç'bëri mësuesja e shkollës fillore për të sinqerizuar prindërit për cilësitë e tij të vonuara dhe agresive? Ç'bëri familja? Ç'bëri shoqëria? Ç'bëni shokët dhe kushërinjtë? Unë personalisht, si kureshtar që jam, për të njohur psikologjinë e një vrasësi, hapa faqen e tij në "Facebook". Nuk duhej shumë mend për të kuptuar se kisha të bëj me një vrasës. Pamja e tij e ngrirë... Qëndrimi i papërqendruar... Pak foto që kishte hedhur në "FB" tregonin qartë për një person me rrezikshmëri shoqërore... Kjo gjë m'u forcua kur pashë me sytë e mi se si i priste pyetjet e gazetarëve, kokëllart e pa asnjë ndjeshmëri... Edhe njëherë, këta persona i kemi midis nesh, por nuk re-

agojmë. Nuk ua kuptojmë rrezikshmërinë. Nuk jemi të kujdesshëm për t'i hapur rrugë budallait, siç, thotë populli.

Sigurisht, Ritvanët nuk kanë mbaruar. Të tjerë Ritvanë ka midis nesh. Ndaj mendoj dhe dua t'ua transmetoj ju të gjithëve, që të ruhemi dhe të kemi kujdes, pasi të keqen e kemi midis nesh. Personat me armë i kemi midis nesh, të armatosur me kallashë, pistoletë, tritol dhe shkaqet për t'u bërë e pabëra gjenden midis nesh. Ndaj, e keqja duhet pikasur qysh në embrion dhe duhet luftuar qysh në embrion. Ne diskutim pasojën. Ziejnë mediat për ta klasifikuar si një i sëmure psikik. Po të pyesim mjekët psikiater, ata do të na shpjegojnë se ka kaq shumë simptoma të sëmundeve psikike dhe ka kaq shumë forma të shfaqjes së këtyre sëmundeve sa edhe vetë ata nganjëherë gabohen në përcaktimin e sëmundeve.

Problemi nuk qëndron tek këta persona me rrezikshmëri shoqërore, por edhe kujdesi që duhet të kemi në marrëdhëniet tona. Ka persona që reagojnë keq ndaj fytyrës. U merr zjarr truri. Humbin logjikën, u errësohet arsyeja. Bëhen të vetëdijshëm për çfarë kanë bërë vetëm kur e shohin veten brenda hekurave të qelive. Persona të tillë janë potencialisht të rrezikshëm. Budallait, domethënë vrasësit, duhet t'i hapësh vërtet rrugën, për të anashkaluar pasojën.

Është e lehtë për t'i identifikuar dhe parandaluar këta persona. Rastet e shumta tregojnë që në Shqipëri numri i vrasjeve është i madh. Nuk përmenda këtu edhe numrin e vrasjeve për gjakmarrje si dhe shifrën e madhe prej njëzet mijë vetash të personave të ngjujari. Për një popull të vogël si ky yni, shifra e vrasjeve dhe ajo e ngujtimeve është alarmante. Institucionet parandaluese punojnë pak dhe shkel e shko. Në fakt, kjo nuk është detyrë e disa psikologëve, por detyrë e prindërve dhe shoqërisë. Veçanërisht është detyrë e mësuesve të fshatrave të largëta, të cilët duhet të punojnë më shumë me nxënësit për t'i ndërgjegjësuar për sa u përket problemeve që do u dalin në jetë, të cilat nuk mund të zgjidhen me kallashnikov, por me qetësi dhe dashamirësi.

se çështja e Maqedonisë është shumë më kritike sepse atje ose do të kemi ose nuk do të kemi ratifikim marrëveshjeje. Me Kosovën, diskutim i ndarjes, shkëmbimit të territoreve, mund të vazhdojë deri në një farë kohe, të zbehet dhe pastaj të vazhdohet me të njëjtin situatë. Por me Maqedoninë meqë ka pasur një marrëveshje mes dy vendeve, nëse ajo dështon do të ishte shumë më serioze.

Zëri i Amerikës: Një nga temat që është hapur me diskutimin e shkëmbimit të territorit, është se disa njerëz filluan të shprehin shqetësimin se çfarë do të ndodhë në të ardhmen nëse Kosova do që të bashkohet me Shqipërinë. Nëse dy vendet bien dakord, ç'të keqe do të kishte?

David Kanin: Problemi është se jo të gjithë do të bien dakord, as në

botën shqiptare nuk do të bien të gjithë dakord. Nuk është aq e thjeshtë. Le të mos flasim për anën ekonomike, për disa çështje kulturore dhe historike. Për shqiptarët e Maqedonisë problemi bëhet i mprehtë. Ata do të pyesin veten. Çfarë do të bëjmë? A mund të bashkoheni edhe ne me ta? Dhe maqedonasit do të pyesin se ç'do të thotë kjo për vendin e tyre, a mund të mbështetemi tek shqiptarët që të jenë pjesë e këtij koalicioni që kanë pasur që më vitet 1990, me qeverinë me përfaqësues nga të dyja komunitetet? E vë në pikë pyetje Maqedoninë. Por nuk besoj se duhet të shqetësohemi për këtë, sepse kundërshtimi ndaj një Shqipërie të Madhe, brenda komunitetit shqiptar është i konsiderueshëm. Nuk është aq e thjeshtë. Dhe sigurisht ata që nuk janë shqiptarë do të kishin shumë dy-

shime për këtë çështje. Këto gjëra mund të ndodhin në një të ardhme të pacaktuar, por vetëm si rezultat i një konflikti të mëtejshëm. Për fat të keq - dhe ka literaturë për këtë - nëse nuk ka konflikt, është shumë vështirë të kesh zgjidhje të përhershme. Unë nuk po bëhem avokat për konflikt por historikisht negociatat nuk janë të suksesshme, për sa i takon marrëveshjeve të përhershme dhe të pranuarra universalisht. Prandaj unë nuk do ta shikojë diskutimin aktual si bazë për Shqipëri të Madhe, apo ndarje të Kosovës, apo anëtarësim të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Asnjë nga këto nuk ka gjasë që të ndodhë.

Zëri i Amerikës: Domethënë, gjendja do të mbetet për të ardhmen e afërt ashtu siç është?

David Kanin: Do të mbetet për të

ardhmen e afërt, e papërcaktuar. "Ashtu siç është" është e diskutueshme. Ndryshime kemi parë. Shumica e ndryshimeve që kemi parë që nga vitet 1990, kanë qenë shkëmbime territori, ose ndarje, ose lëvizje populatash, të gjitha gjëra që qeveritë dhe intelektualët perëndimorë, thonë se nuk mund të ndodhin dhe kanë thënë që nuk mund të ndodhin që në vitet 1990. Shikoni deklaratat e qeverive perëndimore, akademikëve dhe OJQ-ve gjatë gjithë kësaj kohe, që thonë çfarëdo që të jetë status-quoja, nuk mund të ketë më ndryshim kufijsh dhe në fakt janë bërë ndryshime kufijsh dhe pastaj ajo bëhet status-quoja. Status-quotë nuk mund të zgjasin për gjithmonë. Status-quoja aktuale, sipas mendimit tim do të ndryshojë përsëri.

HOROSKOPI

DASHI
Duhet të bëni shumë kujdes për shëndetin, sidomos personat që vuajnë nga tensioni. Përdorni ide të reja për të fituar më shumë para. Sot do të ndiheni keq nga komentet e partnerit/partneres suaj, por bëni kujdes me veprimet, në mënyrë që të mos pendojeni më pas.

DEMI
Nëse do të jetë e mundur, përpuni që të mos ndërmerrni udhëtime të gjata, pasi nuk jeni në kushte dhe duhura për ta bërë një gjë të tillë, për shkak të shëndetit tuaj. Punori më shumë për disa çështje, të cilat i kenë ende pa zgjidhur. Të afërmit do t'ju bëjnë të shpresoni dhe të ëndërroni, por gjithçka do të varet nga përpjekjet tuaja.

BINJAKET
Do të përballeni me një keqkuptim të mikut/mikes suaj, gjë që do të krijojë edhe një situatë të pakëndshme. Disa shprehje të papritura do t'ju fusin në vështirësi ekonomike. Sot ka gjasë të rritohet nga veprimet e partnerit/partneres suaj, por ai/ajo më vonë gjatë ditës do t'ju befasojë me një surprizë shumë të bukur.

GAFORJA
Do të kaloni një ditë shumë të këndshme. Megjithatë, bëni kujdes se me kë diskutoni për çështje financiare. Sa i përket anës romantike, parashikohet një ditë e mbushur plot dashuri.

LUANI
Mos u shqetësoni shumë për çështje të ndryshme. Përpuni të largoni stresin, pasi nuk ndikon aspak mirë në shëndetin tuaj. Një mik i juaj mund t'ju kërkojë ndihmë për të zgjidhur një problem. Kërkoni falje për sjelljen e ashpër ndaj partnerit/partneres.

VIRGJERESHA
Do të ndiheni shumë mirë nga ana shëndetësore, pavarësisht se do të kaloni një ditë plot tension. Nëse jeni prindër, sot tregohuni të vëmendshëm për shëndetin e fëmijës suaj. Sa i përket anës romantike, gjithçka do të jetë fantastike sot.

PESHORJA
Do të ktheheni pas tek disa vendime të gabuara në të kaluarën, çfarë do t'ju bëjë të ndiheni shumë keq. Ndoshta do të jeni më mëdyshje për të vendosur se çfarë hapash të ndërmerri më tej. Përpuni të cilrohni nga stressi duke zgjidhur një mënyrë argëtimi me të afërmit tuaj.

AKREPI
Bëni kujdes me peshën dhe filloni të bëni sa më shumë ushtrime fizike. Shmangni ushqimet pikante dhe të yndyrshme. Përpuni të kontrolloni veten, pasi mund të shqetësoni personat rreth jush dhe t'i pasojë mund të mbeteni vetëm.

SHIGJETARI
Do të keni kohë mjaftueshme për t'u relaksuar. Përpuni të kujtoni momentet tuaja më të bukura, pasi do të ndikojë pozitivisht në gjendjen emocionale. Sa i përket anës romantike, nuk do të jetë dita juaj me fat.

BRICJAPI
Edhe pse do të keni një ditë shumë të ngarkuar, sërish do të mundni ta përballoni lodhjen. Bëni kujdes, pasi ka gjasë të shpenzoni më shumë se buxheti juaj. Do ta keni shumë të vështirë ta kaloni pjesën tjetër të ditës pa praninë e familjarëve.

UJORI
Sot do të ndiheni shumë të relaksuar, çfarë do t'ju kënaqë pamasë. Gjatë ditës do të lidheni me disa persona shumë të rëndësishëm. Mos u përpuni të detyroni të tjerët të bëjnë gjëra pa dëshirën e tyre.

PESHQIT
Veprimet tuaja të shpejta do të ndikojnë në zgjidhjen e disa problemeve afatgjata. Në punë do të përballeni me disa çështje të vështira, por do t'i zgjidhni me ndihmën e kolegëve. Tregohuni sa më origjinalë, pasi sajaset vetëm do t'ju dëmtojnë.

Më shumë se 300 organizata mediatike në Shtetet e Bashkuara do të nisnin një fushatë për të kundërshtuar sulmet e presidentit amerikan, Donald Trump, për të promovuar shtypin e lirë. "The Boston Globe" bëri thirrje javën e kaluar për një reagim të gjerë në shkallë kombëtare, ndaj "luftës së ndyrë" të presidentit kundër medieve, duke e titulluar atë "Enemy Of None" (Armiq të askujt). Trump i ka etiketuar raportimet e medieve si "lajme të rreme" dhe i ka cilësuar gazetarët si "armiqtë e popullit". Ekspertët e Kombeve të Bashkuara kanë thënë se këto deklarata nxisin rrezikun e përdorimit të dhunës kundër gazetarëve. "The

300 organizata mediatike reagojnë pas "luftës së ndyrë" të presidentit

Trump i quan "armiqtë e popullit", mediat amerikane nisnin fushatë pas sulmeve të tij

RREZIKU

"The Boston Globe" bëri thirrje javën e kaluar për një reagim të gjerë në shkallë kombëtare, ndaj "luftës së ndyrë" të presidentit kundër medieve, duke e titulluar atë "Enemy Of None" (Armiq të askujt). Trump i ka etiketuar raportimet e medieve si "lajme të rreme" dhe i ka cilësuar gazetarët si "armiqtë e popullit". Ekspertët e Kombeve të Bashkuara kanë thënë se këto deklarata nxisin rrezikun e përdorimit të dhunës kundër gazetarëve.

Boston Globe" kishte premtuar se do të shkruante një editorial mbi rreziqet e sulmit të administratës mbi shtypin, më 16 gusht, e u kërkoi edhe

mediave të tjera të bënin të njëjtën gjë. Reagimi pozitiv fillostar nga 100 organizata mediatike urrit, duke i bashkuar nismës 350 gazeta të

mëdha kombëtare apo gazeta lokale, mes tyre edhe të përditshme të rëndësishme ndërkombëtare si "The Guardian". Fushata e së enjtes vjen pas



një serie incidentesh dhe komenteve të Trumpit që kanë shtuar presionin mbi median. Ndërsa vajza e Trumpit, Ivanka e ka distancuar veten nga

sulmet e babait të saj mbi median; Sekretarja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders refuzoi të thoshte se media nuk është "armiku i popullit".

Gazetarët britanikë promovojnë në Europë librin për presidentin kosovar

Nëse zgjidhen mos marrëveshjet mes Kosovës dhe Serbisë deri në pranverën e vitit të ardhshëm, ekzistojnë mundësitë që presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi; ai i Serbisë Aleksandar Vučić dhe përfaqësuesja e lartë e BE, Federica Mogherini të nominohen për çmimin Nobel për Paqe. Siç raporton e përditshmja serbe "Danas", duke i referuar burimeve ndërkombëtare diplomatike, hapi i parë drejt nominimit të mundshëm të Presidentit të Kosovës është promovimi i librit të tij më të ri autobiografik "New State, Modern Stateman" nëpër shtetet perëndimore. Autorët e librit autobiografik të presidentit Thaçi janë gazetarët britanikë, Roger Boys dhe Suzy Jagge. Ky libër deri më tani është promovuar në Londër, Berlin, Paris dhe Vjenë. Ndërkaq, në mars të po këtij viti, kur vetë presidenti Thaçi ishte duke promovuar këtë libër në Londër, u publikua një letër që ish-prokurori i Tribunalit Ndërkombëtar të Hagës, Geoffrey Nice i dërgoi qeverisë së Kosovës. Aty Nice aku-

Thaçi, Vuçiç e Mogherini mund të nominohen me çmimin Nobel

Media serbe: Po punojnë për të fituar titullin



zonte ish-kryeministrin Thaçi, tanimë president, se i ka mbetur borxh për punën që kishte bërë në librin e tij autobiografik. Nice zbuloi se Hashim Thaçi ka paguar me


para të shtetit librin autobiografik të shkruar nga dy gazetarët Suzy Jagge dhe Roger Boys. Në komunikimin e ish-prokurorit dhe avokatit britanik Nice me qeverinë ak-

tuale të Kosovës, ai shprehet i mlllefosur nga mënyra se si e kanë injoruar atë institucionet e Kosovës, ndonëse, ai thotë se i kanë borxh mbi gjysmë milioni euro.

MBRETËRESHA E MUZIKËS "SOUL"

Shuhet ikona e muzikës, Aretha Franklin

Mbretëresha e muzikës "soul", Aretha Franklin ka ndërruar jetë dje në shtëpinë e saj në Detroit, e rrethuar nga familja dhe miqtë, pas një beteje të gjatë me sëmundjen. Ajo ishte 76 vjeçe. Aretha Franklin ishte nënë e katër djemve. Familja e saj u bëri thirrje për "lutje dhe privatësi", raporton "Showbiz 411". Aretha Franklin nuk ishte paraqitur në publik prej nëntorit të vitit të kaluar, kur mori pjesë në festivalin e Elton John "AIDS Foundation", në Nju Jork. Ajo i kishte anuluar dy koncerte të planifikuara në muajt mars dhe prill të këtij viti. Performanca e saj e fundit publike ishte në qendër "Mann" në Filadelfia, në gusht të vitit 2017. Në përfundim të shfaqjes, ajo kishte thënë se ishte mposhtur nga lodhja dhe dehidratimi. Krijuesja e hitit "Respect" luftoi me sëmundjen gjatë shtatë viteve të fundit. Në vitin 2011, ajo mohoi raportimet se po vuante nga kanceri i pankreasit, por më vonë e pranoi se kishte bërë një operacion. Aretha Franklin ishte vajza e një kleriku baptist. Ajo u lind në Memphis, Tennesi, më 1942. E filloi karrierën profesionale në muzikë kur ishte 18 vjeçe.




Brenda tri vjetëve, ajo publikoi disa nga hitet e saj më të famshme, me të cilat arriti kulmin e famës, përfshirë hitet "Respect" dhe "U Say a little pray". Aretha fitoi 18 "Grammy Awards", u fut në "Rock and Roll Hall of Fame" në vitin 1987 dhe u bë një nga artistet më të shitura të muzikës së të gjitha kohërave, duke shitur më shumë se 75 milionë disqe. "Një forcë nga parajsja. Diçka që e bën Zoti. Dhe Aretha është një dhuratë nga Perëndia", shkruante revista "Rolling Stone", e cila e quante atë, këngëtareshën më të madhe të të gjitha kohërave.

FOTOLAJMI

Një numër i madh balenash u vranë nga banorët e ishujve Faroe në Atlantik dhe si pasojë, një pjesë e mirë e bregut të oqeanit u mbush me gjakun e tyre. Dëshmitarët e ngjarjes tragjike u shprehën se peshkatarët i dërguan balenat drejt brigjeve duke i sulmuar për vdekje. Madje, edhe fëmijët e moshës 5-vjeçare ndihmuan balenat që të shkonin drejt vdekjes. Një student i Universitetit të Kembrixhit, 22-vjeçari Alastair Wars pa të gjithë ngjarjen e rëndë. Ai tha: "Po shëtitnim rreth brigjeve, kur banorët e ishullit vrapuan duke bërtitur 'Jemi me fat, balenat po vijnë'. Menduam që do të ishte vetëm një që po vinte, por gjithnjë e më shumë rritej numri i tyre që shfaqej në horizont. Nuk mund ta besoj sa shumë balena ishin. Me varkat e tyre po i detyronin të shkonin në plazh. Në momentin që u afruan në breg, filluan t'i vrisnin. Edhe fëmijët po përfshiheshin duke tërhequr litarët. Ishte e tmerrshme".

PAMJE TË LLAHTARSHME, PERGJAKEN BRIGJET E ATLANTIKUT

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashë.
15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotualet.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë.
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Entë Operative Tiranë
34. Agjenci Ajrore Durrës.

36. Një pjesë e dimensioneve.
39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Eshhtë e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishte nija që preu Alekdansdri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

VERTIKAL

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshhtë metri i trobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshhtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshhtë marrëveshje me nota.
25. Ishte babai i Akilit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshhtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Eshhtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshhtë ngjinja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Entë Ekonomike Sarandë.


35. Mbyllin një ditar.
36. Sateliti i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Eshhtë kolana në filma.
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Inicialet e Nolte aktor.
47. Eshhtë tokë që... fitohet.
48. Një... gjermane.

VERTIKAL


1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lujtes.
19. Castellitto aktor.
20. Inicilat e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshhtë tryzni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktor.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	2			8		3		
			7					2
		4				9		6
	9			2			4	
			1		7			
	1			6			5	
9		6				8		
7					1			
		3		4			2	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar



1	4	6	2	9	5	8	3	7
7	5	8	3	6	1	4	9	2
9	2	3	4	7	8	1	6	5
2	1	7	8	4	9	3	5	6
5	3	4	1	2	6	9	7	8
6	8	9	5	3	7	2	1	4
8	7	2	6	1	3	5	4	9
4	6	1	9	5	2	7	8	3
3	9	5	7	8	4	6	2	1

Argëtim filozofik

- Ata që gahen më shumë, janë ata që vuajnë më pak.
- Askush nuk është i kënaqur me fatin e tij, edhe nëse ai është i mirë. Dhe askush nuk është i pakënaqur nga mendja e tij, edhe nëse është më e keqja.
- Kur jemi të lumtur jemi gjithmonë të mirë, por kur jemi të mirë nuk jemi gjithmonë të lumtur.
- Optimist është një njeri që sheh dritë atje ku nuk ka. Pessimist është budallai i cili përpiqet ta shuajë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

F	E	R	M	A	N	I	L	T	J	N	A
A	K	S	I	G	O	V	A	L	E		
R	O	N	E	P	L	F	R	E	N	A	T
A	H	I	E	O	K	R	T	E	T	E	D
A	D	E	M	O	S	T	E	N	I	I	K
D	I	K	A	S	T	E	R	E	T	N	O
A	M	A	L	I	A	I	Z	E	N	E	A
D	E	L	E	R	A	E	O	E			
A	R	I	E	P	I	T	E	T	E	T	
I	O	M	A	I	D	M	A	D	H	I	
S	R	I	R	I	E	L	I	R	E	N	
T	E	R	R	O	R	I	A	R	E	N	A
L	U	I	S	S	P	A	M	A	L	I	A
A	L	K	T	R	O	B	E	R	I	A	
P	P	E	R	I	O	D	I	K	B	N	A
F	I	N	A	L	J	A	A	R	N	A	
R	E	P	A	N	T	E	T	N	S	T	A
T	E	R	E	K	S	I	P				
P	A	R	E	I	T	R	U	K	E	T	I
A	R	I	T	R	E	A	L	K	U	P	A
S	F	I	T	I	M	E	T				
T	A	N	D	E	M	N	E	R	E	U	R
A	H	O	T	E	L	E	T	T	R	A	U
I	U	K	A	T	E	R					

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Breshka që ecën në rrugë të drejtë, kalon edhe kalin në rrugë të keqe.
- Të mos pranosh gabimin që ke bërë, do të thotë se bën një gabim të dytë.
- Fshirja një pjese nga e kaluara, është si të fshish një pjesë përkatëse nga e ardhmja.
- Jeta është një trëndafil, ku çdo petal është një

